



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 66/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |            |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha  | Kryetar    |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar     |
| Lindita Skeja | Anëtar     |
| Merita Zeqaj  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 07.02.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë*”, me nr. REF-46811-12-26-2019, me objekt “*Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative*”, me fond limit 625.000.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

**Ankimues:** “Korsel” sh.p.k.  
Shëtitore “Fan Noli”, përballë Supermarket Elisabet, Korçë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Pogradec  
Lagja Nr.2, Bulevardi “Reshit Çollaku”, Pogradec

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.12.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë*”, me nr. REF-46811-12-26-2019, me objekt “*Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative*”, me fond limit 625.000.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

II.2. Në datën 30.12.2019, operatori ekonomik ankimues “Korsel” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kritereve të kualifikimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

*[...] Ne daten 27.12.2019 eshte hedhur ne SPE procedura me Objekt "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave te qytetit Pogradec dhe Njesive Administrative".*

Nga kontrolli i ushtruar ne DST verejme nje sere shkeljesh te LPP dhe RrPP te cilat po i renditim me poshte.

1. 2.3.2 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesit Teknik për Bashkinë Pogradec, të cilët duhet të figurojnë në licensën profesionale të shoqërisë (1 ndërtimi/ mjedisi dhe 1 Gjeodet), të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

a) Librezë pune (përkatëse)

b) Diplomë

c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesit Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës.

d) Drejtuesit teknik duhet të figurojnë te punesuar prane shoqerise te pakten 12 muajt e fundit.

e) Minimalisht njëri prej drejtuesve teknik të shoqerise te disponoje deshmi trajnimi si "Specialist per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune" ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier".Per drejtuesin teknik te shoqerise duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Per pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.

f) Minimalisht njëri prej drejtuesve teknik të shoqerise te disponoje deshmi trajnimi për "Administrimin e Mbetjeve Urbane" e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.

g) Drejtuesit Teknik nuk duhet të figurojë të dypunësuar. Si rrjedhojë OE duhet të lëshojë një deklaratë ku të specifikohet se drejtuesit teknik nuk janë të dypunësuar apo të angazhuar në ndonjë veprimtari tjetër jashtë OE pjesmarrës. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Ky kriter i vendosur nga ju si AK eshte ne kundershtrim me Ligjin. Nga interpretimi i kriterit te vendosur ju si AK kerkoni 2 Drejtues Teknik 1 Ing. Ndertimi/Mjedisi dhe nje Gjeodet. Ne VKM Nr. 943 Dt.28.12.2016 shprehet qarte se: Drejtuesi teknik i shoqerise, eshte nje, ose me shume individe, te cilet disponoje diplome te nivelit master profesional apo shkencor, apo diplome te integruar te nivelit te dyte, te jete pajisur me licence profesionale individuale dhe te kete jo me pak se 5 vjet eksperience. Ne rastin kur mesatarja e notave te shkolles se larte per individin, rezulton 9 ose me shume, mund te regjistrohet drejtues teknik dhe me 3 vite eksperience. Individi mund te perfitoje licencen individuale, njekoheesisht, me vendosjen si drejtues teknik. Pra ju si AK nuk mund te percaktoni Profesionet e Drejtuesit Teknik. Ne lidhje me Ing. Gjeodet ju bejme me dije se ju si Ak jeni ne kundershtrim me Nenin 28 Pika 2 te RrPP [...].

Punimet qe kryen ing.Ing. Gjeodet Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale qe kerkojne mjete dhe organizim te vecante, punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbeshtetese dhe qendrushmeri terrenesh. Kerkojme nga ana e juaj qe te hiqet Ing. Gjeodet nga kriteret sepse nuk eshte ne perpjestim me kontraten dhe sherbimet qe do te kryhen gjate zbatimit te kontrates.

2. Kandidati ofertues duhet te kete te punesuar dy Inxhinier Mekanik, te cilet te kene nje eksperience pune jo me pak se 5 vjet, si dhe te figurojne te punesuar prane shoqerise te pakten 6 muajt e fundit shoqeruar me dokumentacionin e meposhtme:

*Libreze pune (perkatese)*

a) *Diplome*

b) *Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)*

*Kerkesa juaj si AK per 2 Ing Mekanike eshte e tepert dhe jo ne perpjestim me sherbimet qe do te kryhen. Mjafton vetem nje Ing. Mekanik per zbatimin e kontrates Objekt Prokurimi kjo e bazuar ne Nenin 28 pika 2 te VKM Nr. 914 te RrPP. "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates". Kerkojme qe edhe kjo pike te rishikohet nga ana e juaj.*

3. Kandidati ofertues duhet te kete te punesuar Inxhinier Agronom, të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet, si dhe te figuroje i/e punesuar prane shoqerise te pakten 6 muajt e fundit shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

a) *Librezë pune (përkatëse)*

b) *Diplomë*

c) *Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)*

d) *Te disponoje License Profesionale Sherbimi ne Zbatim leshuar nga Komisioni i Dhenies se licensave Profesionale ku te kete te perfshire kategorine 14 b (Pastrimi i siperfaqeve urbane)*

*Ne lidhje me kriterin e mesiper ku ju si AK shpreheni se Ing. Agronom duhet te disponoje Licence Profesionale Sherbimi ne Zbatim leshuar nga Komisioni i Dhenies se licensave Profesionale ku te kete te perfshire kategorine 14 B (Pastrimi i siperfaqeve urbane) ju bejme me dije se keni ngushtuar kriterin vetem te ING Agronom kur ne VENDIMIN NR.412, DT 15.9.1992 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER KRIJIMIN E KOMISIONIT TE POSACEM PER DHENIEN E LICENCAVE PROFESIONALE", shprehet qarte se licenen Profesionale perfshire kategorine 14 b (Pastrimi i siperfaqeve urbane) mund ta disponoje cילו person qe verteton se ka mbaruar minimumi nje shkollë te larte te cfaredo lloj dege. Prandaj nga sa thame me siper ky kriter te ndryshohet.*

4. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur nga Qendra Kombetare e Licensimit me; Leje Mjedisore te leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit me kod III.I.A per pastrim larje sprucim kontinieresh ne menyre qe te riperdoren. Ne lidhje me kerkesen e mesiperme; sqarojme se referuar ligjit ne fuqi nuk leshohet leje mjedisore Kodi III.I.A me objekt (pastrim larje sprucim kontinieresh ne menyre qe te riperdoren), pasi nuk ekzsiton asnje leje e tille me kete pershkrim pasi: Ne nenin 46, pika 1 germa "a" dhe "b" ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) *kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhet kontrata;*

b) aftesia teknike: operoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesia organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervedjen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates;

Ne nenin 28, pika 5, germa "a" e Vendimit nr. 914, date 29.12.2014 te Keshillite Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, percaktohet Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: a) licencat profesionale per realizimin e sherbimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore.

Ne seksionin Fusha III, "Kategoria III.I, "Per ndikimin ne mjedis", pika 1 dhe 2 germa "a" te Vendimit nr.538 date 26.05.2009 te Keshillit te Ministrave "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullimet e tjera nenligjore te perbashkta", te ndryshuar parashikohet se: "Lejet mjedisore te percaktuara ne 34 pika 5 e ligjit nr.8934, date 5.9.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar bejne pjese ne kategorine III.I te shtojces se ligjit nr. 10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise" 11[11]. 2. Lejet e ndikimit ne mjedis ndahen ne tre nen kategorori si vijon:

a) "Leje e thjeshte mjedisore" me kodin III.I.A;

b) "leje mjedisore" me kodin III.I.B;

c) "leje e integruar mjedisore" me kodin III.1.C. 12

Dhenia e lejeve te mjedisit percaktohet sipas nje sistemi te perbere prej tri nivelesh, mbeshtetur ne madhesine dhe llojin e veprimtarise qe ka nevojte te pajiset me leje, si dhe ne mundesine qe ka ajo veprimtari te shkaktojte ndotje ne ate mase qe mund te sjelle dem ne mjedis dhe te rrezikojte shendetin e njeriut: a) kategoria e veprimtarive A, per te cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A; b) kategoria e veprimtarive B, per te cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B; c) kategoria e veprimtarive C, per te cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit C. Kategorite e veprimtarive dhe kufijte ndermjet tri niveleve nga Ligjit nr.10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit, i ndryshuar" i cili ne nenin 3 pika 12 parashikon se: Leje mjedisit e tipit A eshte leja per veprimtarite e percaktuara ne aneksin I/A, e pergatitur nga Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, te leshuar nga QKL-ja, qe i jep te drejten e funksionimit, teresisht ose pjeserisht instalimit te tipit A, sipas percaktimit te ketij ligji, dhe qe permban te shkruara kushtet e nevojshme per te garantuar, se instalimi permbush kerkesat e ketij ligji dhe te legjislacionit ne fuqi. Nje leje mund te mbuloje nje ose me shume instalime. Ne nenin 4 te Ligjit nr.10448, date 14.07.2011 "Per lejet emjedisit", I ndryshuar, I cili ne nenin 3 pika 12 te tij parashikon se: Ne perputhje me ligjin nr. 10431, date 9.6. 2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", krijohet njesistem prej tri nivelesh te lejeve te mjedisit, te tipit A, B e C, si me poshte: a) leja e mjedisit e tipit A eshte e detyrueshme per kryerjen e veprimtarive te kategorise A, lista dhe pragjet perkatese te te cilave jane percaktuar ne shtojcen I/A te ketij ligji; Ne nenin 8 te Ligjit nr.10448 (date) 4.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar parashikohet se: "Pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji, instalimet e kategorise A pajisen me leje mjedisi te tipit A, ne perputhje me percaktimet e ketij ligji. E njejta leje mjedisi e tipit A mund te lejoje funksionimin e me shume se nje instalimi te te njejtit operator ne te njejtjen vendndodhje. Instalimet e operatoreve te ndryshem, qe ndodhen ne te njejtjen vendndodhje dhe instalimet e te njejtit operator, qe ndodhen ne vendndodhje te ndryshme kerkojne leje te vecanta te tipit A, B apo C, sipas rastit. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar

nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme. Ne interpretim te dispozitave te mesiperme ligjore, si edhe nenit 46 pika 1 dhe nenit 28 te Vendimit nr.914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar ne baze te se ciles vendosen edhe kriteret e vecanta per kualifikim qellimi i autoritetit kontraktor dhe synimi i kerkeses se autoritetit kontraktor lidhet me vertetimin se operatoret ekonomike pjesemarres disponojne licencat e nevojshme per kryerjen e veprimtarise se kontrates se prokurimit objekt ankimi. Ne rastin konkret autoriteti kontraktor ka kerkuar disponueshmerine e licences se fushes III kategori I nenkategoria "A". Per nje interpretim te sakte te kerkeses se autoritetit kontraktor si edhe kuadrit ligjor ne fuqi ne harmoni me te gjitha normat e tjera, vleresojme se duhet ti drejtohem legjislacionit sektorial. Keshtu, konkretisht ligji baze nepermjet te cilit leshohen edhe licencat dhe lejet ne Republiken e Shqiperise eshte ligji nr. 10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise" i cili ne shtojcen e tij parashikon se Fusha III e lejeve perfshin lejeve kategoria I perfshin lejet per aktivite te cilat kane ndikim ne mjedis. Gjithashtu edhe akti i dale ne zbatim te ketij ligji Vendimi nr.538 date 26.05.2009 te Keshillit te Ministrave "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashekta ", te ndryshuar ne asnje rast nuk parashikon nje leje mjedisore e kategorise III.I.A ne perputhje me objektin e vendosur nga autoriteti kontraktor. Vete VKM 53/2011 referon se kushtet e vecanta te nenkategorive te lejeve percaktohen nga ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 PER MBROJTJEN E MJEDISIT. Ky ligj parashikon detyrimin e paisjes me leje mjedisore te nenkategorise A, B, C par duke referuar ne zbatim te nje ligji tjeter, sic eshte ligji nr.10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit, i ndryshuar ". Vete ky ligj ne aneksin e tij nuk parashikon ne asnje rast se leja e fushes III l nenkategoria A jepet per nje objekt specifik ne fushen e menaxhimit te mbetjeve me pershkrim (pastrim larje sprucim kontinieresh ne menyre qe te riperdoren). Sa me siper, licencimi ne Republiken e Shqiperise me leje te fushes III.1 nenkategoria A I nenshtrohet kuadrit ligjor sektorial ne te cilin nuk parashikohet nje leje specifike per kete fushe me kete pershkrim. Kjo kerkese eshte e trajtuar edhe ne vendimin e KPP 762/2018.

Sa me siper kerkojme formulimin mbi menyren e plotesimit te kriterëve te vecanta te kualifikimit ne perputhje me parshikimet e nenit 74 te VK.M 914/2014. Kerkojme pranimin e ankeses dhe modifikim e kriterëve te vecanta per kualifikim si mesiper te argumentuara dhe te mbeshtetura ne prova dhe ligj.

5. Leje mjedisore Tipi C me Kod III.I.A te leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit per Riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave.

Ky kriter i vendosur nga ana e juaj eshte teresisht i jashte ligjshem dhe nuk gjen baze ne aktivitetin e Sherbimit Objekt Prokurimi dhe si i tille duhet te hiqet sepse ne asnje nga zerat e preventivit nuk kemi te bejme me riparim mjetesh. Ky eshte nje aktivitet te cilin Operatoret mund ta relizojne nepermjet Operatoreve qe e ofrojne kete sherbim dhe mund te jene te licencuar. Ne VKM 914 te RrPP Nenin 28 pika 2 shprehet qarte se: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te

gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese natyren dhe vleren e kontrates". Prandaj kerkojme qe ky kriter te hiqet si i pa bazuar ne Ligj dhe VKM.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensë profesionale të Shoqërisë, sipas modelit të lëshuar nga MPPTT ose MTI e vlefshme, për kategoritë si mëposhte:

1. NP-12 A (punime te inxhinierise se mjedisit)
2. NP-9 A (Punime dhe mbrojtje lumore)
3. NS-18 A (Punime Topogjeodezike).

Edhe kriteri i mesiperm nuk eshte ne perpjestim ose i lidhur ngushte me objektin dhe me sherbimet qe do te kryhen sepse kategorite e Licences se Zbatimit NP 9 dhe NS 18 kryejne ekzaktesisht punimet e meposhtme: "N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

Konsiderohen ndertime, mirembajtje ose ristrukturime me nderhyrje te sakta ose ne rrjet, sido qe te jene realizuar, te nevojshem per sistemimin e rrjedhjes se ujerave natyrale ose artificiale, si edhe per mbrojtjen e territorit nga keto ujera, te kompletuara me punimet lidhese te nevojshme. Perfshin ne menyre te thjeshtuar kanale lundruese, grykederdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave te aneve te lumenjve dhe perrenjve, argjinatura te llojeve te ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik te ujerave siperfaqesore te veprave te diafragmave te argjinaturave dhe qendrueshmerise se shpateve.

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale qe kerkojne mjete dhe organizim te vecante, punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbeshtetese dhe qendrueshmeri terrenesh." Nga sa shihet me siper si dhe nga preventivi i hedhur ne SPE asnje nga zerat e punime nuk korenspondon. Edhe zeri Pastrim i lumenjve qe eshte ne Preventiv nuk ka. te beje aspak me punimet e mbrojtjes lumore sepse kemi te bejme vetem me pastrimin nga mbetjet qe hedhin banoret ne lume dhe jo me nderhyrje per mbrojtjen lumore. "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese natyren dhe vleren e kontrates".

Prandaj nga sa thame me siper te dy pikat NP 9 dhe NS 18 te hiqen sepse jane te pa bazuara ne Ligj dhe jane diskriminuese per Operatoret Ekonomike.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 3 (tre) copë;
- b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 7-10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 4 (kater) copë;
- c) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me fshesa anësore , sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012 jo më pak se 1 (një) copë;
- d) Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 2 (dy) copë;

- e) *Gazelona per transportimin e mbetjeve te vellimshme e vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*
  - f) *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë*
  - g) *Mjet special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit, e cila nepermjet thikave ben depertimin ne rere jo me pak se 30 cm thellesi, dhe me performance jo me pak se 20.000 m2 ne ore dhe me depozite per transportimin e mbetjeve me vellim jo me pak se 1.8 m3, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*
  - h) *Mjet traktor i cili terheq mjetin special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit me kapacitet tërheqës jo me pak se 125 KË, jo më pak se 1 (një) copë*
  - i) *Mjet borepastruese e cila duhet te jete e kompletuar me pajisjet e pastrimit te bores dhe shpemdardjes se kripes, jo më pak se 1 (nje) copë.*
  - j) *Makine teknologjike kompaktore e pajisur me mekanizem (Grejfer) per zbrazjen e kontenjereve 3.2 m<sup>3</sup>. Kjo makineri duhet te jete e shoqeruar me fotografi te saj ne momentin e ngritjes dhe te zbrazjes te kontenierit te specifikuar ne kete pike. (Kjo kerkohet per arsye se ne qytetin e Pogradecit jane te vendosur rreth 15 konteniere te ketij lloji, te cilet mbajne rreth 3 here me shume mbeturina se kontenieret e zakonshem), jo më pak se 1 (një) copë*
  - k) *Frezë pastrimi i trotuareve nga dëbora, jo më pak se 2 (dy) copë.*
  - l) *Fshesë automatike me motorr me djegie të brendshme e pajisur ne sistem thithje për pastrimin e trotuarëve, jo më pak se 2 (dy) copë.*
  - m) *Fshesë automatike e pajisur me sistem thithës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 6 (Gjashte) copë.*
  - n) *Mjet special per pastrimin e liqenit ne thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo më pak se 1 (një) copë*
  - o) *Eskavatore me zinxhira, jo më pak se 2 (dy) copë*
- Per Mjetet teknologjike te kerkuara ne piken 2.3.13, germa a - j, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte:*

- a) *Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar).*
- b) *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe e shoqëruar nga dokumentacioni i plotë i cdo mjeti përkatës dhe foto të secilit mjet ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.*

*Percaktimi nga ana e autoritetit kontraktor i vitit te prodhimit te makinerive eshte nje kriter diskriminues dhe eshte ne kundeshitim me nenin 1 dhe 2 te LPPs se. Makinerite kolaudohen nga kompania "SGS Albania" e cila percakton nese makina ploteson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave te motorit ne ajer etj.,) sipas legjislacionit ne fuqi per te qarkulluar ne rruget e Republikes se Shqiperise. Kur makinerite kolaudohen ne baze te rregullave te percaktuara ne Manualin e Kontrollit te Mjeteve nga shoqeria "SGS Albania" atehere keto makineri mund te perdoren ne Republikën e Shqiperise.*

*Vendosja e vitit te prodhimit nga autoriteti kontraktor si kusht skualifikimi eshte nje kriter diskriminues, i pabazuar ne VKMnr. 914, date 29.12.2014 dhe LPP. Kerkojme heqjen e ketij kriteri per vitin e prodhimit te mjeteve jo me pak se viti 2012. Te njejtin qendrim ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr. 748/2017.*



Autoriteti juaj ka kerkuar provueshmerine e disponueshmerise se mjeteve ose me pronesi ose me qera. Ne formen e kerkuar nga ju te provimit te disponueshmerise se mjeteve parashikohet vetem pronesia ose marrja me qera (e cila ne konceptin juridik perfshin dy elemente te pronesise posedim dhe perdorim) nderkohe qe nuk keni dhene mundesine e disponueshmerise se mjeteve qe mund te vihen ne dispozicion me forma te ndryshme dhe konkretisht me ane te kontrates se porosise, parashikuar nga neni 914 i Kodit Civil ose kontratave te blerjes se mjeteve me kusht (ne rast te shpalljes fitues). Nje praktike e ngjashme ndiqet nga shume autoritete kontraktore madje, te njejtin qendrim ka mbajtur edhe Komisioni I Prokurimit Publik ne vendimin KPP 28/2018.

Ne lidhje me mjetet: Mjet special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit, Freze pastrami I trotuareve nga debor, Fshese automatike me motorr me djegie te brendshme e pajisur ne sistem thithje per pastrimin e trotuareve jo me pak se 2 (dy) cope; Fshese automatike e pajisur me sistem thithes dhe me kosh per grumbullimin e mbeturinave, jo me pak se 6 (Gjashte) cope, Mjet special per pastrimin e liqenit ne thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo me pak se 1 (nje) cope ju si AK duhet te jeni me te qarte dhe te percaktoni mire llojin e mjetit dhe specifikimet e ketyre mjeteve qe Operatoret Ekonomike pjesmares ti hartojne ofertat e tyre ne perputhje me ato mjete qe ju kerkoni. Ju si AK duhet te vini ne dispozicion te OE edhe modele te ketyre, mjeteve pa percaktuar marke si dhe specifikimet teknike. Kjo kerkese eshte e bazuar edhe ne LPP ku thuhet se Autoritetet Kontraktore duhet te hartojne kriteret sa me te qarta dhe konkrete.

Kerkojme modifikim e kriterit duke hequr vitin e prodhimit te mjeteve dhe paraqitjen e mjeteve me Kontrate Porosie ose blerje me kusht, si dhe percaktimin sa me te sakte te mjeteve dhe paisjeve se bashku me Specifikimet Teknike te tyre.

8. Per mjetet ne pronesi/qera, Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pese) diteve nga mbyllja e dorezimit te ofertave rezervon te drejten e verifikimit te tyre. Ne kete deklarate do te jepen te dhena te sakta te kontaktit te operatorit ekonomik si: Numer cel, adrese emaili, adresa e selise se shoqerise. Nga ana e autoritetit kontraktor do te dergohet nje njoftim si ne adresen elektronike ne SPE edhe ne te dhenat e kontaktit te OE ku do te percaktohet vendi dhe ora e paraqitjes se mjeteve prane ambienteve te Bashkise Pogradec. Ne rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon te gjitha mjetet e deklaruar ne tender, ai do te s'kualifikohet. Gjithashtu ndryshimet qe mund te perkojne me te dhenat e mjetit te deklaruar dhe atyre qe te rezultojne nga verifikimi fizik i tyre do te perbej shkak per skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar. Ky kriter i vendosur cenon fshehtesine e procesit si nje nga hallkat themelore te ketij Legjislacioni sepse KVO ose AK nuk duhet te kete asnje kontakt me Operatoret pjesmares deri ne perfundimin e vleresimit te ofertave. Duke ju referuar nenit 62 "Detyrimet gjate zbatimit te kontrates" te LPP, autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Sjellim ne vemendje se, referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e sherbimit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkëljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.

Ne rastin konkret, ju si autoritet kontraktor po prokuroni nje sherbim me objekt per te cilen ka zgjedhur llojin e procedures "Procedure e Hapur" dhe jo sherbim konsulence, ne te cilen te gjykohet se cilin nga pjesmarresit ka dhene zgjidhjen me te favorshme apo me optimale lidhur me mjetet e propozuara. Paraqitja e kesaj Deklarate eshte e pavlefshme edhe ne rastin e mjeteve me kontrate porosie. Kerkojme qe ky kriter te hiqet.

9. Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te disponoje nje pike per larjen dhe dizinfektimin e kazaneve (lavazh) ne pronesi apo me qera (ne formen e kerkuar nga ligji, me certifikate pronesie nese eshte ne pronesi, me kontrate qeraje nese eshte marre me qera shoqeruar me dokumentacionin e perkates.)

Ne lidhje me kete kriter duhet te hiqet nga Kriteret e Vecanta sepse Operoret Pjesmarres mund ta realizojne ne ambientet e Oficines qe ju keni kerkuar prej 1000 m<sup>2</sup> dhe mund te kerkoni vetem paisjet e lavazhit. Kerkojme qe ta modifikoni kete kriter.

10. Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te paraqese dokumentin (aktmarreveshje apo kontrate mirembajtje) qe do te kryej sherbimin e mirembajtjes kazanave me subjektin qe do te riparoje kazanat e mbledhjes se mbeturinave. Se bashku me aktmarreveshjen apo kontraten e mirembajtjes duhet te paraqitet dhe dokumentacion provues qe ofruesi i sherbimit ka si aktivitet te tij mirembajtjen e kazaneve. Edhe per sa i perket ketij kriteri Operoret Ekonomike mund ta realizojne vete kete proces pune pa pasur nevojën e Subjekteve te profilizuara sepse ne dijenine tone nuk ka Subjekte qe meren me riparimin e konteniereve, por Operoret e realizojne vete prane ificinave te tyre. Prandaj kerkojme heqjen e ketij kriteri te panevojshem.

Nga sa parashtruar me siper po dhe ne baze te LPP dhe RrPP kerkojme: 1. Pezullimin e procedures. 2. Pranimin e ankeses. 3. Ndryshimin e Krieteve te Vecanta.

II.3. Referuar ankesës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.8601/5 prot., datë 31.12.2019 i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Korsel” sh.p.k. duke e refuzuar atë. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes së ankesës së tij nga ana e autoritetit kontraktor, në datë 06.01.2020, duke paraqitur gjurmimin postar të shkresës së mësipërme. Konkretisht, autoriteti kontraktor në kthim përgjigje ka argumentuar:

[...] Ne lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues per modifikimin e dokumenteve te procedures se prokurimit me pretendimet se: "AK nuk mund te percaktoje profesionet e drejtuesve teknike", "Ing Gjeodet nuk eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit" "Dy inxhinier mekanik nuk Jane ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se nrokurimit, "Inxhinier Agronom nuk eshte ne proporcion me natyren .

Në Shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet se:

2.3.2 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesit Teknik për Bashkinë Pogradec, të cilët duhet të figurojnë në licensën profesionale të shoqërisë (1 ndërtimi/ mjedisi dhe 1 Gjeodet), të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

a) Librezë pune (përkatese)

- b) Diplomë
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesit Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës.
- d) Drejtuesit teknik duhet të figurojnë te punësuar prane shoqerise te pakten 12 muajt e fundit.
- e) Minimalisht njëri prej drejtuesve teknik të shoqerise te disponoje deshmi trajnimi si "Specialist per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune" ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier".Per drejtuesin teknik te shoqerise duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Per pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.
- f) Minimalisht njëri prej drejtuesve teknik të shoqerise te disponoje deshmi trajnimi për "Administrimin e Mbetjeve Urbane" e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.
- g) Drejtuesit Teknik nuk duhet të figurojë të dypunësuar. Si rrjedhojë OE duhet të lëshojë një deklaratë ku të specifikohet se drejtuesit teknik nuk janë të dypunësuar apo të angazhuar në ndonjë veprimtari tjetër jashtë OE pjesmarrës. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

2.3.3 Kandidati ofertues duhet te kete te punesuar dy Inxhinier Mekanik , të cilët të kenë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet, si dhe te figurojnë te punesuar prane shoqerise te pakten 6 muajt e fundit shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune (përkatëse)
- b) Diplomë
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)

2.3.5 Kandidati ofertues duhet te kete te punesuar Inxhinier Agronom, të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet, si dhe te figuroje i/e punesuar prane shoqerise te pakten 6 muajt e fundit shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- e) Librezë pune (përkatëse)
- f) Diplomë
- g) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)
- h) Te disponoje License Profesionale Sherbimi ne Zbatim leshuar nga Komisioni i Dhenies se licensave Profesionale ku te kete te perfshire kategorine 14 b (Pastrimi i siperfaqeve urbane)

Ne nerun 46, pika i germa "a" dhe "b" ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik.", i ndryshuar parashikohet se : " [ ... ]. Në nenin 28, pika 5, germa "a" c Vendimit nr. 914, date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per mitatimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, percaktohet: [...].

Referuar parashtrimeve me shkrim te operatorit ekonomik ankimues, KSHA konstaton se ne lidhje me pretendimin e mesiperme, ankimuesi ka ngritur pretendime nc lidhje me kerkimin e autoritetit kontraktor mbi disponueshmerine ne stafin teknik te operatoreve ekonomike pjesemarres ne

proceduren e prokurimit publik nje inxhinier i cili njeherazi do te kryeje edhe funksionet e drejtuesit teknik, i cili duhet te permbushë tre kushte kumulative, eksperiencia 5 vjecare, formimi arsimor (inxhinier kimist ose mjedisi) si edhe disponueshmeria e certifikimeve perkatese. Ne lidhje me kundershtrimet e mesiperme te operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve te vecanta te kualifikimit, per proceduren e prokurimit objekt ankimi, KSHA gjykon se eshte me vend te ndalet ne nje test balancues te dy elementeve kryesore, Se pari, nese kerkesa ne fjale eshte e pershtatshme per arritjen e synimit te kerkuar dhe se dyti, nese kerkesa ne fjale shkon pertej asaj, se cfare eshte e nevojshme per te arritur synimin. Gjithashtu, ne shqyrtimin e kriteret e mesiperme te kualifikimit, KSHA gjykon te ndalet edhe ne faktin nese kriteri i mesiperme eshte ne proporcion me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet ne zbatim te nenit 46 pika l te LPP-se. Ne pergjigje te testit te sipercituar te proporcionalitetit, KSHA gjykon se kriteret per kualifikim venclosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatorët ekonomike pjesemarrës ne proceclumt e prokurimit. Operatorët ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme. Sa me siper, synimi i autoritetit kontraktor ne rastin konkret eshte vertetimi se operatorët ekonomike ankinmes disponojne staf te kualifikuar dhe akoma me teper stafi i propozuar do te gezoje kompetencat dhe detyrimet e drejtuesit teknik per ofrimin e sherbimit te pastrimit te qytetit, objekt i kontrates se procedures se prokurimit objekt ankimi. KSHA gjykon se për realizimin e synimit të sipercituar të autoritetit kontraktor, ky i fundit në përputhje me nenin 28, pika 5, germa "a" e Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar ka parashikuar disponueshmerine e stafit teknik te nevojshem per realizimin e kontrates. Akoma me tej, inxhinieri I kerkuar nga ana e autoritetit kontraktor do te kryeje njeherazi edhe detyren e drejtuesit teknik. Se pari, ne lidhje me preteridimet e operatorit ekonomik ankimues e autoriteti kontraktor nuk mund te percaktoje profesionin e drejtuesit teknik, KSHA se pari sqaron se drejtuesi teknik nuk eshte profesion, por eshte titull e dhene nga Komisioni I Dhenies se Licencave, nderkohe qe profili i drejtuesit teknik (shkollimi) percaktohet duke marre ne konsiderate nenin 46 pika l te ligjit nr. 9643 date 20. 11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar, pra qe kriteret e kualifikimit te jene ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit. Per rrjedhoje, KSHA vlereson se profili i drejtuesit teknik mund te jete ne cmimin e operatorit ekonomik, pasi ne hipotezen se operatori ekonomik do te propozonte drejtues teknik nje inxhinier elektrik, kjo e fundit nuk eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit. Akoma me tej, KSHA konstaton se ne parashtrimet drejtuar autoritetit kontraktor, operatori ekonomik ankimues ka parashtruar pretendime referuar nje baze ligjore e cila nuk ka lidhje me proceduren e prokurimit objekt ankimi. Konkretisht Vendimi Nr. 943, date 28.12.2016 Per Disa Ndryshime Dhe Shtesa Ne Vendimin Nr.759, Date 12.11.2014, Te Keshillit Te Ministrave, "Per Licencimin Profesional Te Individeve Dhe Personave Juridike Qe Do Te Ushtrojne Veprimtari Ne Fushen E Studimit E Te Projektimit Ne Nderitim Dhe Mbikeqyrjes E Kolaudimit Te Punimeve Te Zbatimit Ne Nderitim" rregullon marredheniet juridike te drejtuesve teknike qe ushtrojne funksione ne fushen e projektimit mbikqyrjes dhe kolaudimit, nderkohe qe ne rastin konkret, mardhenia juridike

*rregulloher nga Vendimi Nr.42, date 16.1.2008 Per Miratimin E Rregullores Per Kriteret Dhe Procedurat E Dhenies Se Licencave Profesionale Te Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Te Subjekteve Juridike, qe Ushtrrojne Veprimtari Ndertimi i cili parashikon se: c, "Drejtues teknik"-individit/et e diplomuar ne degjet perkatese te universitetit qe eshte/jane pergjegjes/a per ndertimin e objekteve sipas projektit dhe ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune brenda kushteve te kontrates."*

*Se dyti, ne lidhje me kerkimin e autoritetit kontraktor se inxhinieri drejtues teknik duhet te jete inxhinier mjedisi, dhe gjeodet, pare kjo ne raport me natyren e procedures se prokurimit objekt ankimi, natyren e sherbimit per te cilen do te jete drejtues teknik (ofrim i sherbimit te pastrimit te qytetit te it), si edhe volumin dhe kompleksitetin e sherbimit.*

*Konkretisht, referuar preventivit te sherbimeve pjese e dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimi rezulton se nder te tjera ne zerat me nr. rendor 11, 12, 14, 15 parashikohen punimet si:*

*11 Mirembajtje lumi i qytetit dhe lumit te Verdoves*

*12 Pastrim i thelle lumenjsh me eskavatore + transport inertesh (lumi I qytetit dhe lumi Verdoves)*

*14 Pastrim I molit te qytetit nga mbetjet vajore te mjeteve motorrike ne uje*

*15 Pastrim me mjet te posacem te leshterikeve ne thellesi*

*Gjithashtu ne specifikimet teknike te procedures se prokurimit objekt ankimi eshte parashikuar edhe specifikimet teknike te kryerjes se sherbimeve te mesiperme.*

*Sa me siper KSHA gjykon se kerkesa e autoritetit kontraktor ne lidhje me natyren e formimit arsimor (inxhinier mjedisi dhe gjeodet) te kerkuar eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e punimeve objekt te kontrates se prokurimit. KSHA sqaron se ne rastin konkret nuk kemi te bejme me nje kontrate klasike te perzgjedhur vetem per kryerjen e sherbimit te grumbullimit te mbeturinave te qytetit, por njekohesisht edhe te pastrimit te lumit, pastrimit te thelle te tij si edhe pastrimin me mjete teknologjike te posacme te leshterikeve ne thellesi te liqenit. Sqarojme se per vete specifikes qe ka edhe qyteti i pogradecit dhe Liqeni I Ohrit, I cili bazuar ne Vendimin e Komiteti i Trashegimise Boterore ne sesionin e 43-te te zhvilluar ne Baku te Azerbajxhanit miratoi me shumice votash kerkesen e Shqiperise per regjistrimin e pjeses shqiptare te Liqenit te Ohrit ne Listen e Trashegimise Boterore qe mbrohet nga UNESCO. Gjithashtu punimet e mesiperme per zerat me nr. Rendor 11.12.14.15 kerkojne njekohesisht edhe disponueshmerine e inxhinierit gjeodet per kryerjen e punimeve gjeodezike ne kuptim te kategorise se Licences NS.18 ku ne Vendimi Nr.42, date 16.1.2008 Per Miratimin E Rregullores Per Kriteret Dhe Procedurat E Dhenies Se Licencave Profesionale Te Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Te Subjekteve Juridike. Qe Ushtrrojne Veprimtari Ndertimi parashikohet se: "Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale qe kerkojne mjete dhe organizim te vecante, punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike: rrjeta mbeshetese dhe qendrueshmeri terrenesh." Akoma me tej, deshmia eksperiencas minimale prej 5 vitesh eshte ne perputhje dhe proporcion me natyren, objektin dhe volumin e procedures se prokurimit. Ne lidhje me disponueshmerine e dy inxhinierëve mekanik, KSHA vlereson se kerkesa e mesiperme eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, referuar shtojces 8 "Kriteret e Vecante te Kualifikimit", eshte kerkuar disponueshmeria e te pakten 15 lloje mjeteve teknologjike me sasi te ndryshme, te nevojshme per kryerjen e sherbimit disa prej te cilave mjete teknologjike të një natyre të vecante si (Mjet special per pastrimin e liqenit ne thellesi nga algat/leshterikeve*

apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo me pak se 1 cope te cilat ne rast defekti kerkojne edhe njohuri te vecanta teknike ne nivel inxhinier per riparimin e tyre me synim mos cenimin e vijueshmerise se punes ne territorin e Bashkise Pogradec. Gjithashtu, KSHA konstaton se Njesia e Prokurimit ne percaktimin e kriterëve te vecanta te kualifikimit ka mbajtur ne konsiderate edhe kufinjte e procedures se prokurimit duke mos kerkuar mjete teknologjike shtese (rezerve) duke ulur kostot e operatorit ekonomik ankimues, por njeherazi kjo e fundit kerkon disponueshmerine e garancive te nevojshme qe ne rast te defekteve te disponohet stafi teknik I nevojshem per riparimin e tyre me synim mos nderprerjen e sherbimit te pastrimit. Akoma me tej, KSHA gjykon se kontrata e mesiperme eshte e shtrire gjate ne kohe (5 vjet) dhe ne percaktimin e kriterëve te vecanta te kualifikimit merret ne konsiderate edhe kuadri ligjor qe rregullon marrdheniet e punes dhe konkretisht:

Konkretisht ne nenin 78, 82, 83, 85, 86, 90, 92 te Kodit te Punes parashikohet se: [...].

Sa me siper, KSHA gjykon se ne percaktimin e numrit te punonjesve eshte marre ne konsiderate fakti se referuar grafikut te sherbimit do te kryhen pa nderprerje nderkohe qe eshte marre ne konsiderate edhe koeficienti i zevendesimit te inxhinierëve per shkak te kohezgjatjes maksimale te kohes se punes, pushimet javore dhe vjetore ne perputhje me kodin e Punes.

Ne lidhje me pretendimet se disponueshmeria e inxhinierit agronom nuk eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit, KSHA konstaton se referuar preventivit te punimeve si me siper analizuar krahas punimeve te mbledhjes dhe largimit te mbeturinave eshte parashikuar edhe kryerja e punimeve te pastrimit te lumenjeve te qytetit dhe te Njesive Administrative si edhe te Liqenit te Ohrit i cili tashme eshte ne listen e trashegimi natyrore qe mbrohet nga UNESCO. Liqeni i Pogradecit ka nje bimesi te pasur prej 125 bimesh ujore. Llojet me te zakonshme jane *Phragmites australis*, *Potamogeton spp.*, *Chara spp.*, *Ceratophyllum spp.*, *Myriophyllum spp.* Gjashte zonat e njepasnjeshme te bimesise percaktohen ne vijim: Zona 1: *Chara spp.*, Zona2: *Potamogeton spp.*, Zona 3: Zona e kallamishteve - *Phragmites australis*, Zona 4: llojet me gjethe pluskuese, Zona 5: Zona Palustrine cthe Zona: *Charatea*.

Fauna bentike e liqenit te Pogradecit permban nje dendesi dhe shumellojshmeri te larte speciesh. Ne zone gjenden lloje arkaike, endemike e te rralla dhe liqeni eshte i famshem per kete, Sfungjeri i rrumbullaket *Ochridospongia rotunda* gjendet vetem ne liqenin e Pogradecit dhe eshte nje lloj endemik e i rralle, Grupi me i perhapur dhe me i madh ne numer jane *Gastropodet* (kermijte), dhe shumica e tyre ne liqen jane lloje endemike. Niveli i larte i endemizmit perfaqesohet gjithashtu nga taksonet e tjere te tille si *Tricladida*, *Oligochaeta*, *Hirudinea*, *Ostracoda*, *Amphipoda* dhe *Isopoda*. Fito dhe zoo-planktoni, mikroalgat, jane tregues biologjike shume te ndjeshem ndaj ndryshimeve ne regjimin/cilesine e ujit. Fitoplanktoni perfaqesohet me shume nga *Cyclotella ocellata*, *Achnanthes minutissima*, *Achnanthes biasoletiana*, *Fragilaria capucina*, etj

Korani Pogradeci perfaqeson nje perqindje te larte (60%) te llojeve te peshqve endemike. Ne liqen gjenden 21 lloje natyror peshqish, 11 prej te cileve shfrytezohen per qellime tregtie. Dy salmonidet, korani - *Salmo letnica* dhe belushka - *Salmothymus ohridanus*, jane deri me tani llojet me te rendesishme ne peshkim pasuar nga gjuheza (*Alburnus alburnus*), krapi (*Cyprinus carpio*), ngjala (*Anguilla anguilla*) dhe gumeci (*Rutilus rubilio ohridanus*). Gjate viteve te fundit, ne liqen jane hedhur lloje peshqish jo natyror si ylber (*Oncorhynchus mykiss*), barkuleci (*Gambusia affinis*) apo sharoku laraman (*Lepomis gibbosus*). Keto lloje nuk jane te afta te riprodhohen ne menyre natyrore dhe tani konsiderohen si te zhdukura. Ne kushte te tilla, disponueshmeria e inxhinierit

agronom eshte teper e rendesishme per kryerjen e sherbimit te pastrimit te liqenit sipas proceseve si me siper arsyetuar, pasi per vete specifiket e kesaj re fundit. KSHA vlereson se kerkesa per disponueshmerine e licences 14 b (Pastrimi i siperfaqeve urbane) nuk eshte e lidhur me natyren e profilit te inxhinierit te kerkuar, por fakti se inxhinieri I kerkuar duhet te deshmoje se disponon kategorine e mesiperme te licences ne respekt te nenit 28 pika 5 te Vendimit nr. 914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar. Sa me siper pretendimi nuk qendron.

2. Ne lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes per disponueshmerine e kategorive te licenes, NP 9 dhe NS 18 me pretendimin se keta te fundit nuk jane ne proporcion me natyren dhe volumin e kontrates, KSHA vlereson se: Ne shtojcen 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" "Kapaciteti Teknik" te dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimi parashikohet se:

2.3.12 Operatori ekonomik duhet te paraqese license profesionale te Shoqerise, sipas modelit te leshuar nga MPPTT ose MTI e vlefshme, per kategorite si meposhte:

1. NP-12 A (punime te inxhinierise se mjedisit)

2. NP-9 A (punime dhe mbrojtje lumore)

3. NS-18 A (Punime Topogjeodezike)

(Per Operatoret e huaj te behet njehsimi i licences profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Institucionit perkates, ne plotesim te licencave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates).

Ne nenin 46, pika germa "b" ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se: [...]. Ne nenin 28, pika 5, germa "a" e Vendimit nr. 914, date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, percaktohet: [...].

Referuar parashkrimeve me shkrim te operatorit ekonomik ankimes, KSHA konstaton se ne lidhje me pretendimin e mesiperme, ankimesi ka ngritur pretendime ne lidhje me kerkimin e autoritetit kontraktor mbi disponueshmerine e NP-9 A (Punime dhe mbrojtje lumore) dhe NS-18 A (Punime Topogjeodezike) nuk eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit, KSHA veren se:

Ne Vendimi Nr.42, elate 16.1.2008 Per Miratimin E Rregullores Per Kriteret Dhe Procedurat E Dhenies Se Licencave Profesionale Te Zbatimit. Klasifikimit Dhe Disiplinimit Te Subjekteve Juridike, Qe Ushtrojne Veprimtari Ndertimi i cili parashikon se: "Drejtues teknik"- individet e diplomuar ne degjet perkatese te universitetit qe eshte/jane pergjegjes/a per ndertimin e objekteve sipas projektit dhe ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune brenda kushteve te kontrates."

Gjithashtu parashikohe se: "1. Kategorizinti dhe klasifikimi i licences, garanci a) Licenca eshte dokument juridik e profesional qe i jep te drejte disponuesit te saj te ushtroje veprimtari te caktuar, sipas: I. Kategorive te punimeve te zbatimit duke u mbeshtetur ne: - profilin e diplomes universitare te individeve qe punesohen ne rolin e drejtuesit teknik te shoqerise."

Gjithashtu ne lidhjen 3 parashikohet se: "NP. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Konsiderohen ndertime mirembajtje ose ristrukturime me nderhyrje te sakta ose ne rrjet, si do qe te jene realizuar, te nevojshme per sistemimin e rrjedhjes se ujerave natyrale ose artificiale si edhe per mbrojtjen e territorit nga keto ujera, te kompletuara me punimet lidhese te nevojshme. Perfshin ne menyre te thjeshtuar kanale lundruese, grykederdhjet e lumenjve,

*konsolidimin e strukturave te aneve te lumenve dhe perrenjve, argjinatura te llojeve te ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e rregjimit hidraulik te ujerave siperfaqesore te veprave te diafragmave te argjinaturave dhe qendrueshmerise se shpateve.*

*NS - 18 Punime topogjeodezike Konsiderohet zbatitni i rilevimeve topografike speciale qe kerkojne mjete dhe organizim te vecante, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbeshetese dhe qendrueshmeri terrenesh.*

*Referuar preventivit te sherbimeve pjese e dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimi rezulton se nder te tjera ne zerat me nr. rendor 11, 12, 14, 15 parashikohen punimet si:*

*11 Mirembajtje lumi i qytetit dhe lumit te Verdoves*

*12 Pastrim I thelle lumenjsh me eskavatore + transport inertesh (lumi i qytetit dhe lumi Verdoves)*

*14 Pastrim I molit te qytetit nga mbetjet vajore te mjeteve motorrike ne uje*

*15 Pastrim me mjet te posacem te leshterikeve ne thellesi*

*Gjithashtu jane parashikuar edhe kryerja e punimeve si me poshte vijon: Pastrim i thelle lumenjsh me eskavator + transport lumi Gur i Kuq dhe lumi i Memelishtit*

*Mirembajtje lumi Rremenj dhe lumi Guras*

*Pastrim i thelle lumenjsh me eskavator + transport lumi Rremenj dhe lumi Guras*

*Mirembajtje lumi Cerrave*

*Pastrim i thelle lumenjsh me eskavator + transport lumi Cerrave*

*Ne lidhje me kundershimitet e mesiperme te operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve te vecanta te kualifikimit, per proceduren e prokurimit objekt ankimi, KSHA gjykon se eshte me vend te ndalet ne nje test balancues te dy elementeve kryesore, Se pari, nese kerkesa ne fjale eshte e pershtatshme per arritjen e synimit te kerkuar dhe se dyti, nese kerkesa ne fjale shkon pertej asaj, se cfare eshte e nevojshme per te arritur synimin. Gjithashtu, ne shqyrtimin e kriteret e mesiperme te kualifikimit, KSHA. gjykon te ndalet edhe ne faktin nese kriteri i mesiperme eshte ne proporcion me natyren dhe permasat e kontraies qe do te prokurohet ne zbatim te nenit 46 pika 1 te LPP-se. Ne pergjigje te testit te sipercituar te proporcionalitetit, KSHA gjykon se kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta cluhet te refuzohen si te papranueshme. Sa me siper, synimi I autoritetit kontraktor ne rastin konkret eshte vertetimi se operatoret ekonomike ankimues disponojne licencat e nevojshme per kryerjen e sherbimit.*

*Referuar preventivit sa me siper vijuar, KSHA konstaton se jane parashikuar punime te. mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Konsiderohen ndertime mirembajtje ose ristrukturime me nderhyrje re sakta ose ne rrjet, si do qe te jene realizuar, te nevojshem per sistemimin e rrjedhjes së ujerave natyrale ose artificiale si edhe per mbrojtjen e territorit nga keto ujera, te kompletuara me punimet lidhese të nevojshme. Perfshin ne menyre te thjeshtuar kanale lundruese, grykederdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të aneve te lumenjve dhe perrenjve, argjinatura te llojeve te ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e rregjimit hidraulik te ujerave siperfaqesore te veprave te diafragmave te argjinaturave dhe qendrueshmerise se shpateve*



*Punime te cilat klasifikohen ne kategorine NP 9. Nderkohe punimet e mesiperme perfshijne njeherazi edhe punime topogjeodizike, ku perfshihen rilevime te shtratit te lumit si pasoje e nderhyrjes se kerkuar.*

*Ne rastin konkret, ne pergjigje te testit te proporcionalitetit, KSHA vlereson se kerkesa e mesiperme eshte e pershtatshme per realizimin e synimit te kerkuar (kryerjes se punimeve te kerkuar nga subjekte te licencuara ne perputhje me kuaderin ligjor ne fuqi) dhe nuk shkon pertej asaj se cfare eshte e nevojshme pasi klasifikimi i kategorive te licences eshte "A" klasifikim minimal ne perputhje edhe me aktin nenligjor ne fuqi. Sa me siper pretendimi nuk qendron.*

*3.Ne lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes mbi modifikimin e dokumenteve te procedures se prokurimit mbi disponueshmerinee mjeteve dhe paisjeve te nevojshme per kryerjen e sherbimit, KSHA konstaton se: Ne shtojcen 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" "Kapaciteti Teknik" te dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimi parashikohet se:*

*2.3.13 Operatori ekonomik duhet te paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

*a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 3 (tre) copë;*

*p) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 7-10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 4 (kater) copë;*

*q) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me fshesa anësore , sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012 jo më pak se 1 (një) copë;*

*r) Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 2 (dy) copë;*

*s) Gazelona per trasnportimin e mbetjeve te vellimshme e vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*

*t) Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë*

*u) Mjet special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit, e cila nepermjet thikave ben depertimin ne rere jo me pak se 30 cm thellesi, dhe me performance jo me pak se 20.000 m2 ne ore dhe me depozite per transportimin e mbetjeve me vellim jo me pak se 1.8 m3, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*

*v) Mjet traktor i cili terheq mjetin special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit me kapacitet tërheqës jo me pak se 125 KË, jo më pak se 1 (një) copë*

*w) Mjet borepastruese e cila duhet te jete e kompletuar me pajisjet e pastrimit te bores dhe shperndarjes se kripes, jo më pak se 1 (nje) copë.*

*x) Makine teknologjike kompaktore e pajisur me mekanizem (Grejfer) per zbrazjen e kontenjereve 3.2 m³. Kjo makineri duhet te jete e shoqeruar me fotografi te saj ne momentin e ngritjes dhe te zbrazjes te kontenierit te specifikuar ne kete pike. (Kjo kerkohet per arsye se ne qytetin e*

*Pogradecit janë të vendosur rreth 15 konteniere të këtij lloji, të cilët mbajnë rreth 3 here me shumë mbeturina të konteniervet të zakonshme), jo më pak se 1 (një) copë*

- y) *Frezë pastrimi i trotuarëve nga dëbora, jo më pak se 2 (dy) copë.*
- z) *Fshesë automatike me motor me djegie të brendshme e pajisur në sistem thithje për pastrimin e trotuarëve, jo më pak se 2 (dy) copë.*
- aa) *Fshesë automatike e pajisur me sistem thithës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 6 (Gjashtë) copë.*
- bb) *Mjet special për pastrimin e liqenit në thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo më pak se 1 (një) copë*
- cc) *Eskavatore me zinxhira, jo më pak se 2 (dy) cope*

*2.3.14 Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 2.3.13, gërma a – j, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- a) *Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar).*
- b) *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe e shoqëruar nga dokumentacioni i plotë i cdo mjeti përkatës dhe foto të secilit mjet ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.*
- c) *Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - çertifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Për mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - çertifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; kontratën përkatëse të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- d) *Për mjetet e tjera të cilat nuk shënohen në regjistrat publike, pronesi/qera duhet të paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore përkatëse ose cdo dokument tjetër sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi, të cilat vërtetojnë posedimin e mjeteve ose pajisjeve.*
- e) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe karakteristikat e tij..*
- f) *Për mjetet në pronësi/qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga mbyllja e dorëzimit të ofertave rezervon të drejtën e verifikimit të tyre. Në këtë deklaratë do të jepen të dhëna të sakta të kontaktit të operatorit ekonomik si : Numër cel, adresë emaili, adresa e selisë së shoqërisë. Nga ana e autoritetit kontraktor do të dërgohet një njoftim si në adresën elektronike në SPE edhe në të dhënat e kontaktit të OE ku do të përcaktohet vendi dhe ora e paraqitjes së mjeteve pranë ambienteve të Bashkisë Pogradec. Në rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon të gjitha mjetet e deklaruar në tender, ai do të s'kualifikohet. Gjithashtu ndryshimet që mund të përkoojnë me të dhënat e mjetit të deklaruar dhe atyre që të rezultojnë nga verifikimi fizik i tyre do të përbëj shkak për skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar*
- g) *Operatori ekonomik që paraqet ofertën duhet të disponojë një mjedis në pronësi ose me qira brenda territorit të Bashkisë Pogradec të pakten 1000 m<sup>2</sup> truall dhe të pakten 100 m<sup>2</sup> ndertese për zhvillimin e këtij aktiviteti për punonjësit dhe stafin drejtues (në formën e kërkuar nga ligji,*

*me çertifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontrate qeraje pranë zyrës noteriale nëse është marrë me qera e shoqeruar me certifikaten e pronësisë të qiradhenesit)*

- h) Operatori ekonomik që paraqet ofertën duhet të disponojë një pikë për larjen dhe dizinfektimin e kazanëve (lavazh) në pronësi apo me qera (në formën e kerkuar nga ligji, me çertifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontrate qeraje nëse është marrë me qera shoqeruar me dokumentacionin e përkatës*
- i) Operatori ekonomik që paraqet ofertën duhet të paraqesë dokumentin (aktmarreveshje apo kontratë mirembajtje) që do të kryej shërbimin e mirembajtjes të kazanëve me subjektin që do të riparojë kazanat e mbledhjes së mbeturinave. Në bashkë me aktmarreveshjen apo kontratën e mirembajtjes duhet të paraqitet dhe dokumentacioni provues që ofruesi i shërbimit ka si aktivitet të tij mirembajtjen e kazanëve*
- j) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet : «Specifikime Teknike », të firmosura e vulosura dhe grafikun e kryerjes së shërbimit të pastrimit sipas afatëve të përcaktuara në specifikimet teknike.*

*Ne nenin 46, pika l germa "b" të ligjit nr. 9643, elate 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: [...]. Ndersa ne nenin 53/3 të LPP-se përcaktohet se: [...].*

*Neni 26 pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: [...].*

*Referuar parashkrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimes, KSHA konstaton se ky I fundit në lidhje me mjetet:*

- a) Fshese automatike e pajisur me sistem thithës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 6 (Gjashtë) cope.*
- b) Mjet special për pastrimin e liqenit në thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo më pak se 1 (një) cope*
- c) Mjet special për pastrimin e reres dhe bregut të liqenit, e cila nëpërmjet thikave ben depertimin në rere jo më pak se 30 cm thellesi, dhe me performancë jo më pak se 20.000 m<sup>2</sup> në orë dhe me depozitë për transportimin e mbetjeve me vëllim jo më pak se 1.8 m<sup>3</sup>, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) cope;*
- d) Freze pastrimi i trotuarëve nga debora, jo më pak se 2 (dy) cope.*
- c) Fshese automatike me motor me djegie të brendshme e pajisur në sistem thithje për pastrimin e trotuarëve, jo më pak se 2 (dy) cope.*

*Ka kerkuar venien në dispozicion të specifikimeve teknike dhe të markave të këtyre të fundit.*

*Në lidhje me kërkesën për venien në dispozicion të specifikimeve teknike të mjeteve dhe paisjeve të mesieprme për kryerjen e shërbimit, KSHA konstaton se procedura e prokurimit objekt ankimi është për kryerjen e shërbimit të pastrimit të qytetit dhe të Njesive Administrative dhe jo të blerjes me anë të procedurave të prokurimit publik të mjeteve dhe paisjeve të nevojshme për kryerjen e shërbimit. Në nenin 11 germa "c" të Vendimit nr. 914 elate 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar parashikohet se: "Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të pakten: - termat e referencës; - grafikun e ekzekutimit; - kërkesat për personelin kryesor". Në rastin konkret detyrimi që rrjedh nga aktin nënligjor në zbatim të ligjit është përcaktimi i termave të referencës së kryerjes së shërbimit si pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe jo i përcaktimit të*

specifikimeve teknike te detajuara per mjetet e nevojshme per kryerjen e sherbimit, KSHA gjykon se detyrimi i autoritetit kontraktor ne percaktimin e mjeteve te nevojshme ne repsekt te parimit te transparences dhe barazise mes operateve ekonomike eshte percaktimi i sakte dhe i drejte i funksionaliteteve te kerkuara te mjeteve dhe paisjeve dhe percaktimin e sakte te dokumentacionit mbi menyren e permbushjes se ketyre te fundit. KSHA pasi mori ne shqyrtim dokumentet e procedures se prokurimit objekt ankimi konstaton se nga ana e Njesise se Prokurimit eshte percaktuar qarte natyra e mjeteve dhe funksionaliteti i kerkuar i tyre duke dhene nje pershkrim te pergjithshem per operatoret ekonomike mbi mjetet e kerkuara per kryerjen e sherbimit. Akoma me tej, referuar metodes se interpretimit per analogji, ne nenin 23 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: "Specifikimet teknike, qe percaktojne karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te pergatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithe kandidatëve e ofertuesve. Kur eshte e mundur, specifikimet teknike duhet te percaktohen ne menyre te tille qe te kuptohen nga personat me aftesi te kufizuara" Nderkohe ne nenin 23 pika 3 germa "b" te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet menyra mbi hartimin e specifikimeve teknike bazuar ne: b) kerkesave ne terma funksionale, kur nje gje e tille kerkon t'u referohesh standardeve kombetare ose nderkombetare, si menyre qe nenkupton pajtueshmeri me kerkesat funksionale; Ne rastin konkret, KSHA vlereson se autoriteti kontraktor ne percaktimin e specifikimeve teknike te mjeteve te kerkuar per kryerjen e sherbimit te pastrimit eshte bazuar mbi termat funksionale te kryerjes se sherbimit te kerkuar. Autoriteti kontraktor nuk mund te referoje ne marka mjetesh, pasi edhe vete ky i fundit ne hartimin e kerkesave te vecanta per kualifikim eshte bazuar mbi percaktimin e specifikimeve teknike mbi nevojen per proceset teknike qe duhet te kryejne mjetet e mesiperme dhe jo mbi marka specifike mjetesh dhe paisjesh. KSHA gjykon se specifikimet teknike te mjeteve dhe paisjeve jane te sakta, nuk shfaqin dykuptueshmeri si edhe nuk lene vend per ekuivoke por sqarojne qartesisht nevojen e kerkuar, per njedhoje nuk shfaqet e nevojshme dhenia e shpjegimeve te shtuara. Mungesa e njohurive specifike e operatorit ekonomik ankimes nuk cenon ligjshmerine mbi menyren e hartimit te kriterëve te vecanta te kualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor.

Së dyti, ne lidhje me shtimin e kerkeses per disponueshmerine e mjeteve me kontrate porosie dhe heqjen e vitit te prodhimit, KSHA vlereson se: Referuar Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni I, pika 2 percaktohet: c) te nxise pjesemarrjen e operateve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndennjet operateve ekonomike. KSHA gjykon se, kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve te operateve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e cluhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetet teknike (makinerite), ne perputhje me volumin e percaktuar ne dokumentat e tenderit. Ne lidhje me kerkimin e autoritetit kontraktor mbi vitin e prodhimit te mjeteve, KSHA gjykon se kerkesa e mesiperme eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e kontrates, i sherben njeherazi jo vetem proceseve te punes se parashikuar por

*njekohesisht edhe ndikimit te tyre ne mjedis. Nje kriter i tille ka per qellim uljen e nivelit te ndotjes qe shkaktohet ne ajer dhe mbi te gjitha eshte vendosur ne harmoni me kriterin tjetër te percaktuar nga autoriteti kontraktor mbi prezencen e nje inxhinieri mjedisi si dhe me natyren dhe objektin e kesaj procedure qe eshte "Pastrimi dhe largimi i mbeturinave". Me qellim respektimin e normatives se ndotjes ne ambjent, meqenese jane mjete teknologjike qe punojne me kohe te zgjatur ne qytet dhe per te pasur nje nivel te ulet ndotjeje ne respektim dhe te normativave te komunitetit europian dhe udhezimeve te Ministrise se Turizimit dhe Mjedisit, KSHA e gjen kriterin e vendosur te drejte dhe proporcional me objektin e kontrates. Sa me siper pretendimi i ankimuesit nuk qendron.*

*Gjithashtu lidhur me pretendimin e ankimuesit se nuk keni dhene mundesine e disponueshmerise se mjeteve qe mund te vihen ne dispozicion me formate ndryshme dhe konkretisht me ane te kontrates se porosise parashikuar nga nenin 914 i Kodi Civil ose kontratave te blerjes se mjeteve me kusht". KSHA vlereson se nenin 913 e vijues te Kodit Civil nder te tjera parashikohet se: Porosia eshte nje kontrate me te cilen njera pale detyrohet te kryeje nje ose me shume veprime juridike per llogari te pales tjetër. Ne rastin konkret, KSHA gjykon se me ane te kontrates se porosise nuk provohet disponueshmeria e mjeteve per kryerjen e sherbimit te pastrimit te qytetit, pasi me anë te kontrates te porosise, njera pale (e porositura) ngarkohet te kryeje veprime juridike ne dobi te porositesit, por ne asnje rast nuk verteton disponueshmerine e mjeteve dhe pajisjeve per kryerjen e sherbimit. Gjithashtu kontrata e shitjes me kusht pezullues ose zgjidhes nuk japin garanci autoritetit kontraktor per disponueshmerine e mjeteve per kryerjen e sherbimit. KSHA gjykon se format e tjera te disponimit te mjeteve pervec kontrates se qerese apo te pronesise se mjeteve sic jane ato per blerjen me kusht apo porosise nuk mund te aplikohen ne rastin konkret. Autoriteti kontraktor kerkon te krijojë bindjen ne ditën e hapjes se ofertave qe mjetet disponohen nga ana e autoritetit kontraktor ne nje nga format ligjore ate te qerese apo ne pronesi por nuk mund te krijojë kete bindje me ane te nje kontrate me kusht sikunder pretendon ankimuesi apo akoma me tej me nje kontrate porosie. KSHA gjykon se operatorët ekonomike ne ditën e hapjes se ofertave duhet provojne para autoritetit kontraktor se plotesojne kapacitetet teknike te nevojshme per realizimin e kontrates. Keto kapacitete nuk mund te jene te kushtezuara me plotesimin e ndonje kushti apo te mund te plotesohen ne te ardhmen pasi vete natyra e procedurave te prokurimit eshte intensive dhe e kushtezuar nga afate kohore. Ne kete kuptim KSHA gjykon se kriteri per disponimin e makinerive me qera ose ne pronesi eshte nje kriter i cili nuk kufizon konkurrencen dhe aq me pak diskriminues. Te njejtin qendrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik si ne lidhje me disponueshmerine e mjeteve me dy nga format e parashikuara ne Kodin Civil ashtu edhe mbi vitin e prodhimit, ne nje ceshtje e cila referuar rrethanave eshte objektivist e ngjashme (menyres se hartimit te kriterëve dhe kundërshtimeve te operatorit ekonomik) me ceshtjen konkrete. Konkretisht ne vendimin KPP 593/2018 mbi shqyrtimin e ankimit te nje operatori ekonomik ankimues per modifikimin e kriterëve te procedures se prokurimit te ofrimit te sherbimit te pastrimit zhvilluar nga Bashkia Sarande eshte shprehur se: "Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e*

nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...” III.5.3. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”. III.5.4. Referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet: c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë III.5.5. Komisioni I Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në lidhje me kërkimin e autoritetit kontraktor mbi vitin e prodhimit të mjeteve, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis. Një kriter i tillë ka për qëllim uljen e nivelit të ndotjes që shkaktohet në ajër dhe mbi të gjitha është vendosur në harmoni me kriterin tjetër të përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi prezencën e një inxhinieri mjedisi si dhe me natyrën dhe objektin e kësaj procedure që është “Pastrimi dhe largimi i mbeturinave”. Me qëllim respektimit e normativës së ndotjes në ambjent, meqënëse janë mjete teknologjike që punojnë me kohë të zgjatur në qytet dhe për të pasur një nivel të ulët ndotjeje në respektim dhe të normativave të komunitetit europian dhe udhëzimeve të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, KPP e gjen kriterin e vendosur të drejtë dhe proporcional me objektin e kontratës. Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron. Gjithashtu lidhur me pretendimin e ankimuesit se nuk keni dhënë mundësinë e disponueshmërisë së mjeteve që mund të vihen në dispozicion me forma të ndryshme dhe konkretisht me anë të kontratës së porosisë parashikuar nga neni 914 i kodit civil ose kontratave të blerjes së mjeteve me kusht” KPP e gjen të pabazuar. KPP gjykon se format e tjera të disponimit të mjeteve përveç kontratës së qerasë apo të pronësisë së mjeteve sic janë ato për blerjen me kusht apo porosisë nuk mund të aplikohen në rastin konkret. Autoriteti kontraktor kërkon të krijojë bindjen në ditën e hapjes së ofertave që mjetet disponohen nga ana e autoritetit kontraktor në një nga format ligjore atë të qerasë apo në pronësi por nuk mund të krijojë këtë bindje me anë të një kontrate me kusht sikundër pretendon ankimuesi apo akoma më tej me një kontratë porosie. KPP

*gjykon se operatorët ekonomikë në ditën e hapjes së ofretave duhet të provojnë para autoritetit kontraktor se plotësojnë kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Këto kapacitete nuk mund të jenë të kushtëzuara me plotësimin e ndonjë kushti apo të mund të plotësohen në të ardhmen pasi vetë natyra e procedurave të prokurimit është intesive dhe e kushtëzuar nga afate kohore. Në këtë kuptim KPP gjykon se kriteri për disponimin e makinerive me qera ose në pronësi është një kriter i cili nuk kufizon konkurrencën dhe aq më pak diskriminues. Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron”.*

*Ne lidhje me pretendimet se kërkesa e parashikuar ne dokumentet e procedures se prokurimit ku parashikohet se: "Per mjetet ne pronesi/qera, Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pese) diteve nga mbyllja e dorezimit te ofertave rezervon te drejten e verifikimit te tyre. Ne kete deklarate do te jepen te dhena te sakta te kontaktit te operatorit ekonomik si: Numer tel, adrese emaili, adresa e selise se shoqerise. Nga ana e autoritetit kontraktor do te dergohet nje njoftim si ne adresen elektronike ne SPE edhe ne te dhenat e kontaktit te OE ku do te percaktohet vendi dhe ora e paraqitjes se mjeteve prane ambienteve te Bashkise Pogradec. Ne rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon te gjitha mjetet e deklaruar ne tender, ai do te s'kualifikohet. Gjithashtu ndryshimet qe mund te perkojne me te dhenat e mjetit te deklaruar dhe atyre qe te rezultojne nga verifikimi fizik i tyre do te perbej shkak per skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 "Per Prokurimin Publik, i ndryshuar" eshte ne kundërshtim me ligjin, KSHA vlereson se kërkesa e mesiperme eshte ne perputhje me nenin 66 pika 2 te Vendimit nr. 914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar ku parashikohet se: [...]. Gjithashtu ne nenin 53 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: [...]. Gjithashtu ne nenin 2 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar parashikohet se: [...].*

*Ne rastin konkret ne respekt te parimit te barazise ne trajtimi e kerkesave dhe detyrimeve qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve autoriteti kontraktor ka percaktuar qe ne dokumentet e procedures se prokurimit se per te gjithë operatorët ekonomike pjesëmarrës do te kryhet verifikimi deklarimeve te mjeteve dhe paisjeve si nje e drejte ligjore e autoritetit kontraktor. Ne lidhje me kundërshtimet e kriterëve te vecanta te kualifikimit mbi disponueshmërinë e mjeteve dhe paisjeve si me poshte vijon:*

*a) Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te disponoje nje mjedis ne pronesi ose me qira brenda territorit te Bashkise Pogradec te pakten 1000 m2 truall dhe te pakten 100 m2 ndertese per zhvillimin e ketij aktiviteti per punonjesit dhe stafin drejtues (ne formen e kerkuar nga ligji, me certifikate pronesie nese eshte ne pronesi, me kontrate qeraje prane zyres noteriale nese eshte marre me qera e shoqeruar me certifikaten e pronesise te qiradhenesit).*

*b) Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te disponoje nje pike per larjen dhe dizinfektimin e kazaneve (lavazh) ne pronesi apo me qera (ne formen e kerkuar nga ligji, me certifikate pronesie nese eshte ne pronesi, me kontrate qeraje nese eshte marre me qera shoqeruar me dokumentacionin perkates.*

*c) Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te paraqese dokumentin (aktmarreveshje apo kontrate mirembajtje) qe do te kryej sherbimin e mirembajtjes kazanave me subjektin qe do te riparoje kazanat e mbledhjes se mbeturinave. Se bashku me aktmarreveshjen apo kontraten e*

mirembajtjes duhet te paraqitet dhe dokumentacion provues qe ofruesi sherbimit ka si aktivitet te tij mirembajtjen e kazaneve.

d) Ne lidhje me pretendimet se pika e lavazhit mund te gjendet edhe brenda truallit prej J ,000 m2 te kerkuar nbrenda territorit te Bashkise Pogradec, KSHA konstaton se referuar kriterete te vecanta te kualifikimit ne asnje rast nuk eshte perjashtuar opsioni se pika e lavazhit mund te jete brenda territorit prej 1.000 m2 te percaktuar ne dokumentet e procedures se prokurimit si pike e nevojshme jo vetem per vendosjen e mjeteve (autopark) por njekohesisht edhe per kryerjen e sherbimit te larjes se konteniereve. KSHA gjykon se ne asnje rast referuar dokumentave te procedures se prokurimit objekt ankimi nuk eshte ndaluar qe operatori ekonomik te disponoje brenda te njejtit territori piken e lavazhit. KSHA gjykon se per autoritetitn kontraktor eshte e nevojshme qe te vertetohet se operatori ekonomik ploteson kapacitetin teknik ne perputhje me kerkesen ku parashikohet se Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te disponoje nje pike per larjen dhe dizinfektimin e kazaneve (lavazh) ne pronesi apo me qera (ne formen e kerkuar nga ligji, me certifikate pronesie nese eshte ne pronesi, me kontrate qeraje nese eshte marre me qera shoqeruar me dokumentacionin e perkates pavaresisht faktit nese kjo pike ndodhet brenda ose jashte territorit prej 1,000 m2 te kerkuar. KSHA gjykon se kerkesa e mesiperme eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit dhe eshte lene ne cmim te operatoreve ekonmike zgjedhja e vendodhjes se pikes.

Ne lidhje me kundershtimet per kriterin ne lidhje me Operatori ekonotnik qe paraqet oferten duhet te paraqese dokumentin aktmarreveshje apo kontrate mirembajtje qe do te kryej sherbimin e mirembajtjes kazanave me subjektin qe do te riparoje kazanat e mbledhjes se mbeturinave. Se bashku me aktmarreveshjen apo kontraten e mirembajtjes duhet te paraqitet dhe dokumentacion provues qe ofruesi i sherbimit ka si aktivitet te tij mirembajtjen e kazaneve. KSHA konstaton se referuar parashtimeve me shkrim te operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se ky kriter mund te plotesohet edhe nga vete operatori ekonomik pa gene nevoja per kontrat~ sherbimi me pale te treta. Ne rastin konkret, KSHA gjykon se synimi i autoritetit kontraktor eshte provueshmeria se operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik per ofrimin e sherbimit te mirembajtjes se konteniereve. Nese me ane te dokumentacionit te kerkuar sa me siper cituar operatori ekonomik provon se permbush vete kete kriter, ne asnje rast ky kriter nuk shfaq diskriminim mes operatoreve. Sa me siper pretendimi nuk qendron.

4. Ne lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik per disponueshmerine e lejeve dhe licencave te nevojshme per kryerjen e sherbimit, KSHA veren se: Ne shtojcen 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" "Kapaciteti Teknik" te dokumenteve te procedures se prokurimit parashikohet se:

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

- Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me kod III.1.A për pastrim larje sprucim kontiniereve në mënyrë qe të ripërdoren.
- Leje mjedisore me Kod III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me objekt stacion transferimi.
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Ndikimin në Mjedis (kodi III.2.A)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullimin dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbime ndërrhyrëse higjieno-sanitare (kodi II.8.B)



- *Leje mjedisore Tipi C me Kod III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit per Riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave.*

*Gjithashtu Ne nenin 46, pika I, germa "b" te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" parashikohet shprehimisht se: [...].*

*Ne VKM nr. 914, elate 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave ne Prokurimit Publik", neni 28 "Kontratat e sherbimeve", pika 2, percaktohet se: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet ti.: perfshijne te gjitha kriteret specifike. ne P,e,putf?je me neni 46 tit LPP. Kriteret du/ët te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast. autoriteti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qi: duhet le paraqesin operatoret ekonomike perpermbushjen e ketyre kriterëve."*

*Neni 28 "Kontatat e Sherbimeve" te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" parashikon shprehimisht se: [...].*

*Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorama te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit ekonomik per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi tekontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit.*

*Ne nenin 5 te ligjit nr. 10 081, date 23.2.2009 PER LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE, i ndryshuar parashikohet se: "1. Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve ne territorin e Republikes se Shqiperise jane, si rregull, te lira dhe nuk i nenshtrohen licencimit apo autorizimit, pervecse kur parashikohet ndryshe me ligj."*

*Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme.*

*KSHA gjykon se ne interpretim te dispozitave te mesiperme ligjore, si edhe nenit 46 pika I dhe nenit 28 te Vendimit nr.914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar ne baze te se ciles vendosen edhe kriteret e vecanta per kualifikim qellimi i autoritetit kontraktor dhe synimi i kerkeses se autoritetit kontraktor lidhet me vertetimin se operatoret ekonomike pjesemarres disponojne licencat e nevojshme per kryerjen e veprimtarise se kontrates se prokurimit objekt ankimi.*

*Ne rastin konkret autoriteti kontraktor ka kerkuar disponueshmerine e licences se fushes III kategori I nenkategoria "A". Per nje intepretim te sakte te kerkeses se autoritetit kontraktor si edhe kuadrit ligjor ne fuqi ne harmoni me te gjithë normat e tjera, vleresojme se duhet ti drejtohem legjislacionit sektorial. Keshtu, konkretisht ligji baze nepermjet te cilit leshohen edhe licencat clhe Iejet ne Republikën e Shqiperise eshte ligji nr.10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqiperisc" i cili ne shtojcen e tij parashikon se Fusha III e lejeve perfshin lejeve kategoria I perfshin lejet per aktivitete te cilat kane ndikim ne mjedis. Ne rastin konkret referuar specifikimeve teknike si edhe preventivit te sherbimeve nder te tjera eshte parashikuar edhe kryerja e dezinfektimit te konteniereve, sherbim I cili ne kuptim te nenit 5 te ligjit*

10081/2009 kryhet vetem nga subjekte te licencuar. KSHA sqaron se kuadri ligjor ne fuqi parashikon fushen e licencimit dhe konkretisht kerkesa per disponueshmerine e licences sipas fusha III.I.A lidhet me zbatimin e ligjit nr. 10 431, date 9.6.2011 PER MBROJTJEN E MJEDISIT. Ky ligj parashikon detyrimin e paisjes me leje mjedisore te nenkategorise A, B, C por duke referuar ne zbatim te nje ligji tjeter, sic eshte ligji nr. 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit, i ndryshuar". Leja/Licenca/Autorizimi leshohet ne baze te objektit te aktivitetit, ndersa kuadri ligjor parashikon edhe kornizen se per cilat raste (ndikimi ne mjedis) leshohet leja e mesiperme.

Ne lidhje me kerkesen per disponueshmerine e Leje mjedisore Tipi C me Kod III.I.A te leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit per Riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave KSHA gjykon se kjo e fundit eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e procedures se prokurimit objekt ankimi. Per sa kohe qe referuar dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimimi eshte kerkuar edhe disponueshemria e pikes se autoparkut per riparimin e mjeteve si edhe dy inxhinierëve mekanik per kryerjen e sherbimit te riparimit te mjeteve ne rast te defekteve dhe me synim qe ne asnje moment te mos cenohet ofrimi i sherbimit te pastrimit te qytetit, operatori ekonomik duhet te deshmoje se disponon lejet dhe licencat e nevojshme per kryerjen e veprimtarise ne perputhje me objektin e procedures se prokurimit objekt ankimi si edhe te gjithë proceseve te nevojshme ndihmese ne funksion te realizimit te synimit. Sa me siper, KSHA gjykon se ne pergjigje te testit te proporcionalitetit sa me siper cituar, kerkesa e mesiperme eshte ne proporcion me objektin dhe volumin e procedures se prokurimit, i sherben synimit te kerkuar dhe nuk tejkalon ate se cfare eshte e nevojshme per realizimin e saj. Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qendron.

Ne mbeshtetje te nenit 63 pika 1.1. te ligjit nr.9643 elate 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar, neni 78 pika 6 te Vendimit nr.914 elate 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar, KSHA VENDOSI:

1. Te mos pranoje ankesen e operatorit ekonomik "Korsel" shpk per proceduren e prokurimit Procedure e Hapur "Mbi Kufirin e Larte Monetar" me mjete elektronike me objekt "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave te qytetit Pogradec dhe Njesive Administrative)" me fond limit 625,000,000.00 lek pa TVSH parashikuar per t'u zhvilluar ne date 18.2.2020 nga autoriteti yne kontraktor Bashkia Pogradec.

2. Kunder ketij venclimi mund te behet ankim prane Komisionit te Prokurimit Publik ne perputhje me nenin 63 te ligjit nr.9643. date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar.

3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere dhe i njoftohet ankimesit ne rruge elektronike dhe postare menjehere si edhe njesise se prokurimit dhe titullarit te autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 09.01.2020 operatori ekonomik "Korsel" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me pretendimet si më poshtë vijon:

[...] Me poshte po parashtrrojme shkeljet e konstatuara.

1. 2.3.2 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesit Teknik për Bashkinë Pogradec, të cilët duhet të figurojnë në licensën profesionale të shoqërisë (1 ndërtimi/ mjedisi dhe 1 Gjeodet), të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

h) Librezë pune (përkatese)

- i) *Diplomë*
- j) *Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesit Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës.*
- k) *Drejtuesit teknik duhet të figurojnë te punësuar prane shoqerise te pakten 12 muajt e fundit.*
- l) *Minimalisht njëri prej drejtuesve teknik të shoqerise te disponoje deshmi trajnimi si "Specialist per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune" ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier".Per drejtuesin teknik te shoqerise duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Per pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.*
- m) *Minimalisht njëri prej drejtuesve teknik të shoqerise te disponoje deshmi trajnimi për "Administrimin e Mbetjeve Urbane" e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.*
- n) *Drejtuesit Teknik nuk duhet të figurojë të dypunësuar. Si rrjedhojë OE duhet të lëshojë një deklaratë ku të specifikohet se drejtuesit teknik nuk janë të dypunësuar apo të angazhuar në ndonjë veprimtari tjetër jashtë OE pjesmarrës. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".*

*Ky kriter i vendosur nga ju si AK eshte ne kundertshtim me Ligjin. Nga interpretimi i kriterit te vendosur ju si AK kerkoni 2 Drejtues Teknik 1 Ing. Ndertimi/Mjedisi dhe nje Gjeodet. Ne VKM Nr. 943 Dt.28.12.2016 shprehet qarte se: Drejtuesi teknik i shoqerise, eshte nje, ose me shume individe, te cilet disponoje diplome te nivelit master profesional apo shkencor, apo diplome te integruar te nivelit te dyte, te jete pajisur me licence profesionale individuale dhe te kete jo me pak se 5 vjet eksperience. Ne rastin kur mesatarja e notave te shkolles se larte per individin, rezulton 9 ose me shume, mund te regjistrohet drejtues teknik dhe me 3 vite eksperience. Individidi mund te perfitoje licencen individuale, njekohesisht, me vendosjen si drejtues teknik. Pra AK nuk mund te percaktoje Profesionet e Drejtuesit Teknik.*

*Ne pergjigjen e AK KSHA eshte shprehur vete se mund te jete ING Mjedisi ose Kimist por ne kriteret e ka percaktuar ING ndertimi ose Mjedisi dhe Ing Gjeodet. Ne lidhje me Ing. Gjeodet theksojme se AK eshte ne kundertshtim me Nenin 28 Pika 2 te RrPP i cili shprehet se: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates".*

*Punimet qe kryen nje Ing . Gjeodet Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale qe kerkojne mjete dhe organizim te vecante, punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike, rrjeta mbeshtetese dhe qendrueshmeri terrenesh.*

*Referuar preventivit te punimeve ne menyre te vecante natyres se punimeve qe do te kryhen gjykojmë se, disponueshmeria ne stafin teknik te nje Inxhinieri gjeodet shfaqet e panevojslune pasi nuk eshte ne proporcion me natyren e shërbimit që kërkohet të realizohet nga Autoriteti kontraktor referuar zerave te përcaktuar në preventiv.*

Autoriteti Kontraktor ne kthimin e pergjigjes I referohet per vendosjen e ketij kriteri zerave te preventivit me numrat respektive 11, 12, 14, 15 të cilat I cilëson zera punimesh gjeodezike dhe vazhdon ne arsyetimin e tij se për realizimin e ketyre punimeve kërkohet disponueshmeria e inxhinierit gjeodet ne kuptim te kategorise NS 18.

Le te evidentojme zerat e preventivit te cilave ju referohet autoriteti kontraktor per vendosjen e ketij kriteri same poshte:

11. Mirembajtje lumi I qytetit dhe lumi I verdoves

12. Pastrim I thelle lumenjsh me eskavator +transport inertesh (lumi I qytetit dhe lumi I verdoves)

14. Pastrim I molit te qytetit nga mbetjet vajorete mjeteve moorrike ne uje

15. Pastrim me mjete te posacme te leshterikeve ne thellesi.

Analizuar zerat e preventivit konstatohet se ne asnje nga zerat nuk perfshihet zbatim I rilevimeve topografike speciale qe kerkojne mjete dhe organizim te vecante nuk ka asnje lloj punimi topogjeodezik ne objekte inxhinierike nuk ka punime speciale gjeodezike as vendosje rrjetash mbeshtetese dhe qendrueshmeri terrenesh ne kuptim te kategorise NS-18 ku kerkohet disponueshmeria e inxhinierit gjeodet.

Vlen te theksojme gjithashtu se referuar specifikimeve teknike te vendosura nga vete autoriteti kontraktor ne piken 27 "Mirembajtje lumenjsh dhe pastrim I thelle lumenjsh", ku percaktohet plani i punes dhe grafiket e punimeve pika I percaktohet specifikisht:

"Mirembajtja e lumenjve do te kryhet cdo dite nepermjet punetoreve te cilet do te jene te pajisur me mjete pune si lopata, karroca etj. Ndersa pastrimi I thelle I lumenjve eshte parashlkuar te kryhet me mjete ekskavator dhe do te kryhet 2 here ne vit per lumenjte lumi I qytetit dhe lumi I verdoves dhe nje here ne vit Guri I kuq, Memelisht, Rremenje, Guras, Lumi I Cerrave".

Sa me siper bejme me dije se ky lloj sherbimi I cili kerkohet te kryhet thjesht me mjete si lopata karroca dhe eskavator nuk ka te beje me asnje punim topogjeodezik dhe as me rilevime topografike dhe hidrografike.

Persa I perket zerit ne preventiv I cili I referohet pastrimit me mjete te posacme te leshterikeve ne thellesi percaktohet ne specifikimet teknike te vena ne dispozicion te operatoreve ekonomik verehet se autoriteti kontraktor ka percaktuar pastrimin e reres se plazhit dhe vijes bregliqenore per te cilin eshte kerkuar perdorimi I nje mjeti I cili ben nje nderhyrje ne rere jo me pak se 30 cm dhe grumbullimin e mbeturinave. Pra jemi ne kushtet e realizimit te nje sherbimi pastrimi aspak kompleks sikunder pretendohet nga autoriteti kontraktor per realizimin me sukses te te cilit arsyetuar sa me siper nuk paraqitet aspak e nevojshme qe operatoret ekonomike te disponojne ne stafin e tyre inxhinier te profilit gjeodet.

Kerkojme qe te hiqet Ing. Gjeodet nga kriteret sepse nuk eshte ne perpjestim me kontraten dhe sherbimet qe do te kryhen gjate zbatimit te kontrates.

2. Kandidati ofertues duhet te kete te punesuar dy Inxhinier Mekanik, te cilet te kene nje eksperience pune jo me pak se 5 vjet, si dhe te figurojne te punesuar prane shoqerise te pakten 6 muajt e fundit shoqeruar me dokumentacionin e meposhtme:

Libreze pune (perkatese)

a) Diplome

b) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)

Ne vendosjen e kriterit per 2 inxhinier mekanik te punesuar me experience jo me pak se 5 vjet sqarojme same poshte:

Ne nenin 46, pika 1 germa "b" e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : " [ ... ] Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sis; eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates; [ ... ]"

Gjykojme se, kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates,

Ne lidhje me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me 2 Inxhinier Mekanik, te punesuar mendojme qe eshte kriter diskriminues I cili nuk ka asnje lidhje me natyren e punimeve qe do te kryhen. Argumentimi se duke qene nje numer i madh mjetesh teknologjike te cilat do te vihen ne dispozicion per realizimin e kontrates te cilat ne rast defekti kerkojne njohuri ne nivelin inxhinierik eshte i pabazuar ne ligj dhe ne fakt duke diskriminuar operatoret ekonomike dhe duke ulur konkurrencen. Inxhinieret mekanik te punesuar prane shoqerive nuk mundet ne asnje rast logjikisht dhe ligjerisht te bejne rregullimin e defekteve te mjeteve riparimi i te cilave mund te behet vetem ne subjekte juridike te kualifikuara dhe te licencuara referuar akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi. Pra theksojme se eshte ligjerisht e pamundur qe nje inxhinier mekanik punesuar prane shoqerise te beje riparim te defekteve te mjeteve teknologjike duke qene i palicencuar per te ushtruar kete veprimtari. Kerkojme qe kjo pike te rishikohet.

3. Kandidati ofertues duhet te kete te punesuar Inxhinier Agronom, të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet, si dhe te figuroje i/e punesuar prane shoqerise te pakten 6 muajt e fundit shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- i) Librezë pune (përkatëse)
- j) Diplomë
- k) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)
- l) Te disponoje License Profesionale Sherbimi ne Zbatim leshuar nga Komisioni i Dhenies se licensave Profesionale ku te kete te perfshire kategorine 14 b (Pastrimi i siperfaqeve urbane)

Ne lidhje me kriterin e mesiperm ku AK shprehet se Ing. Agronom duhet te disponoje Licence Profesionale Sherbimi ne Zbatim leshuar nga Komisioni i Dhenies se licensave Profesionale ku te kete te perfshire kategorine 14 B (Pastrimi i Siperfaqeve Urbane) ju bejme me dije se keni ngushtuar kriteri vetem te ING Agronom kur ne VENDIMIN NR.412, DT 15.9.1992 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER KRIJIMIN E KOMISIONIT TE POSACEM PER DHENIEN E LICENCAVE PROFESIONALE", shprehet qarte se licenen Profesionale perfshire kategorine 14 B (Pastrimi i siperfaqeve urbane) mund ta disponoje cילו person qe verteton se ka mbaruar minimumi nje shkollë te larte te cfaredo lloj dege.

Argumentimi qe autoriteti kontraktor ben se ligeni ka bimesi ujore dhe rreth 22 lloje peshqish te cilet mund te demtohen nga procesi i pastrimit sikunder eshte parashikuar ne specifikimet teknike nuk ka asnje baze dhe per me teper kontrollin e ketij procesi nuk mund ta beje kurrsesi nje inxhinier agronom.

Prandja nga sa thame me siper ky kriter te ndryshohet.

4. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur nga Qendra Kombetare e Licensimit me;

Leje Mjedisore te leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit me kod III.I.A per pastrim larje sprucim kontinieresh ne menyre qe te riperdoren.

Ne lidhje me kerkesen e mesiperme, sqarojme se referuar ligjit ne fuqi nuk leshohet leje mjedisore kodi III.I.A me objekt (pastrim larje sprucim kontinieresh ne menyre qe te riperdoren), pasi nuk ekzsiton asnje leje e tille me kete pershkrim pasi: Ne nenin 46, pika 1 germa "a" dhe "b" ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhet kontrata; b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asetete tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates;

Ne nenin 28, pika 5, germa "a" e Vendimit nr. 914, date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, percaktohet Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: a) licencat profesionale per realizimin e sherbimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore

Ne seksionin Fusha III, "Kategoria III.l. "Per ndikimin ne mjedis ", pika 1 dhe 2 germa "a" te Vendimit nr.538 date 26.05.2009 le Keshillit te Ministrave "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashkta", te ndryshuar parashikohet se: "Lejet mjedisore te percaktuara ne 34 pika 5 e ligjit nr.8934, date 5.9.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit ", i ndryshuar bejne pjese ne kategorine III.l te shtojces se ligjit nr.10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise" 11 [11]. 2. Lejet e ndikimit ne mjedis ndahen ne tre nenkategorit si vijon:

a) "Leje e thjeshte mjedisore" me kodin III.I.A;

b) "leje mjedisore" me kodin III.I.B;

c) "leje e integruar mjedisore" me kodin III.I.C.12

Dhenia e lejeve te mjedisit percaktohet sipas nje sistemi te perbere prej tri nivelesh, mbeshtetur ne madhesine dhe llojin e veprimtarise qe ka nevojte te pajiset me leje, si dhe ne mundesine qe ka ajo veprimtari te shkaktojte ndotje ne ate mase qe mund te sjelle dem ne mjedis dhe te rrezikojte shendetin e njeriut: a) kategoria e veprimtarive A, per te cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A; b) kategoria e veprimtarive B, per te cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B; c) kategoria e veprimtarive C, per te cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit C. Kategorite e veprimtarive dhe kufijte ndermjet tri

niveleve nga Ligjit nr.10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit, i ndryshuar" i cili ne nenin 3 pika 12 parashikon se: Leje mjedisit e tipit A eshte leja per veprimtarite e percaktuara ne aneksion I/A, e pergatitur nga Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, te leshuar nga QKL-ja, qe i jep te drejten e funksionimit, teresisht ose pjeserisht, instalimit te tipit A, sipas percaktimit te ketij ligji, dhe qe permban te shkruara kushtet e nevojshme per te garantuar se instalimi permbush kerkesat e ketij ligji dhe te legjislacionit ne fuqi. Nje leje mund te mbuloje nje ose me shume instalime. Ne nenin 4 te Ligjit nr.10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", I ndryshuar, i cili ne nenin 3 pika 12 te tij parashikon se: Ne perputhje me ligjin nr. 10431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", krijohet nje sistem prej tri nivelesh te lejeve te mjedisit, te tipit A, B e C, si me poshte: a) leja e mjedisit e tipit A eshte e detyrueshme per kryerjen e veprimtarive te kategorise A, lista dhe pragjet perkatese te te cilave jane percaktuar ne shtojcën I/A te ketij ligji; Ne nenin 8 te Ligjit nr.10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar parashikohet se: "I.Pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji, instalimet e kategorise A pajisen me leje mjedisi te tipit A, ne perputhje me percaktimet e ketij ligji. E njejta leje mjedisi e tipit A mund te lejoje funksionimin e me shume se nje instalimi te te njejtut operator ne te njejtën vendndodhje. Instalimet e operatoreve te ndryshem, qe ndodhen ne te njejtën vendndodhje dhe instalimet e te njejtut operator, qe ndodhen ne vendndodhje te ndryshme kerkojne leje te vecanta te tipit A, B apo C, sipas rastit. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar njepanorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane re detyrueshme per t'u permbushur nga operatorët ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme. Ne interpretim te dispozitave te mesiperme ligjore, si edhe nenit 46 pika I dhe nenit 28 te Vendimit nr.914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar ne baze te se cites vendosen edhe kriteret e vecanta per kualifikim qellimi i autoritetit kontraktor dhe synimi i kerkeses se autoritetit kontraktor lidhet me vertetimin se operatorët ekonomike pjesemarres disponojne licencat e nevojshme per kryerjen e veprimtarise se kontrates se prokurimit objekt ankimi. Ne rastin konkret autoriteti kontraktor ka kerkuar disponueshmerine e licences se fushes III kategori I nenkategoria "A". Per nje intepretim te sakte te kerkeses se autoritetit kontraktor si edhe kuadrit ligjor ne fuqi ne harmoni me te gjithë normat e tjera, vleresojme se duhet ti drejtohem legjislacionit sektorial. Keshtu, konkretisht ligji baze nepermjet te cilit leshohen edhe licencat dhe lejet ne Republiken e Shqiperise eshte ligji nr. 10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise" i cili ne shtojcën e tij parashikon se Fusha III e lejeve perfshin lejeve kategoria I perfshin lejet per aktivitete te cilat kane ndikim ne mjedis. Gjithashtu edhe akti i dale ne zbatim te ketij ligji Vendimi nr.538 date 26.05.2009 te Keshillit te Ministrave "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashkta", te ndryshuar ne asnje rast nuk parashikon nje leje mjedisore e kategorise III.IA ne perputhje me objektin e vendosur nga autoriteti kontraktor. Vete VKM 53/2011 referon se kushtet e vecanta te nenkategorive te lejeve percaktohen nga ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 PER MBROJTJEN E MJEDISIT. Ky ligj parashikon detyrimin e paisjes me leje mjedisore te nenkategorise A, B, C por

duke referuar ne zbatim te nje ligji tjeter, sic eshte ligji nr.10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit, i ndryshuar". Vete ky ligj ne aneksin e tij nuk parashikon ne asnje rast se leja e fushes III.I nenkategoria A jepet per nje objekt specifik ne fushen e menaxhimit te mbetjeve me pershkrim (pastrim larje sprucim kontinieresh ne menyre qe te riperdoren). Sa me siper, licencimi ne Republiken e Shqiperise me leje te fushes III. I nenkategoria A i nenshtrohet kuadrit ligjor sektorial ne te cilin nuk parashikohet nje leje specifike per kete fushe me kete pershkrim.

Sa me siper kerkojme formulimin mbi menyren e plotesimit te kriterëve te vecanta te kualifikimit ne perputhje me parshikimet e nenit 74 te VKM 914/2014.

5. Leje mjedisore Tipi C me Kod III.1.A te leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit per Riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave.

Kriteri i vendosur nga AK eshte teresisht i jashte ligjshem dhe nuk gjen baze ne aktivitetin e Sherbimit Objekt Prokurimi dhe si i tille duhet te hiqet sepse ne asnje nga zerat e preventivit nuk kemi te bejme me riparim mjetesh. Ky eshte nje aktivitet te cilin Operatoret mund ta realizojne nepermjet Operatoreve qe e ofrojne kete sherbim dhe mund te jene te licencuar. Ne VKM 914 te RrPP Nenin 28 pika 2 shprehet qarte se: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese natyren dhe vleren e kontrates". Prandaj kerkojme qe ky kriter te hiqet si i pa bazuar ne Ligj dhe VKM.

6. Operatori ekonomik duhet te paraqese license profesionale te Shoqerise, sipas modelit te leshuar nga MPPTT ose MTI e vlefshme, per kategorite si meposhte:

1. NP-12 A (punime te inxhinierise se mjedisit)

2. NP-9 A (Punime dhe mbrojtje lumore)

3. NS-18 A (Punime Topogjeodezike).

Edhe kriteri i mesiper nuk eshte ne perpjestim ose i lidhur ngushte me objektin dhe me sherbimet qe do te kryhen sepse kategorite e Licences se Zbatimit NP 9 dhe NS 18 kryejne ekzaktesisht punimet e meposhtme.

Pasi analizuam me kujdes, preventivin dhe specifikimet teknike te publikuara ne APP per kete objekt tenderi, konstatojme se zerat e punimeve te percaktuara ne preventiv konsistojne ne fshirje rruges, mirembajtje rruges, ngarkim mbeturinash, pastrim plazhi, bregu liqenit, dizifektim kontenieresh, lagie rruges, mirembajtje lumi, pastrim I thelle lumenjsh, lyerje kontenieresh, pastrim moli I qytetit, Irje rruges, pastrim nga bora e kriposje. Mbeshtetur ne vendimit nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbeshtetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori.

Ne lidhjen Nr.3 percaktohet:

N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

Konsiderohen ndertime, mirembajtje ose ristrukturime me nderhyrje te sakta ose ne rrjet, si do qe te jene realizuar, te nevojshem per sistemimin e rrjedhjes se ujerave natyrale ose artificiale si edhe per mbrojtjen e territorit nga keto ujera, te kompletuara me punimet lidhese te nevojshme. Perfshin ne menyre te thjeshtuar kanale lundruese, grykederdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave te aneve te lumene dhe perrenjve, argjinatura te llojeve te ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e



rregjimit hidraulik te ujerave siperfaqesore te veprave te diafrangmave te argjinaturave dhe qendrueshmerise se shpateve.

Sic rezulton kategoria NP-9 mund te kerkohet vetem kur ne preventivm e percaktuar per realizimin e ketij sherbimi, jane parashikuar punime qe permbledh kjo pike, sic edhe i parashtruam me lart dhe ne asnje rast tjeter qe nuk perfshihet ketu nuk mund te kerkohet nje pike e tille. Po te rikthehemi te sherbimet e kerkuara te realizohen ne preventivin e dhene nga autoriteti kontraktor nuk gjejme asnje ze punimi qe te perputhet me punimet qe permbledhe NP- 9. Sqarojme se Kategoria NP-9 parashikon sisteme hidraulike dhe bonifikime dhe punime per mbrojtje lumore te cilat nuk kane asnje lidje me realizimin e sherbimit object I kesaj kontrate. Ne kushtet, kur ky kriter eshte vendosur ne kundershtrim me parashikimet ligjore kerkojme heqjen e ketij kriteri.

NS-18 C (Punime Top gjeodezike), nderkohe qe ne Lidhjen Nr.2 te vendimit nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", percaktohet :

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale qe kerkojne mjete dhe organizim te vecante, punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbeshtetese dhe qendrueshmeri terrenesh.

Sic rezulton kategoria NS-18 mund te kerkohet vetem kur ne preventivm e percaktuar per realizimin e ketij sherbimi, jane parashikuar punime qe permbledh kjo pike, sic edhe i parashtruam me lart dhe ne asnje rast tjeter qe nuk perfshihet ketu nuk mund te kerkohet nje pike e tille. Po te rikthehemi te sherbimet e kerkuara te realizohen ne preventivin e dhene nga autoriteti kontraktor nuk gjejme asnje ze punimi qe te perputhet me punimet qe permbledhe NS-18. Ky kriter eshte diskriminues ne kundershtrim nuk eshte ne proporcion me natyren e kontrate duke mos patur asnje rol ne realizimin e sherbimit per kete arsye kerkojme heqjen e ketij kriteri.

"Kerkesat e vecanta te kualifikimit duh et te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese.natyren dhe vleren e kontrates"

Prandaj te dy pikat NP 9 dhe NS 18 te hiqen sepse jane te pa bazuara ne Ligj dhe jane diskriminuese per Operatoret Ekonomike.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

dd) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 3 (tre) copë;

ee) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 7-10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 4 (kater) copë;

ff) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me fshesa anësore , sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012 jo më pak se 1 (një) copë;

- gg) Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 2 (dy) copë;
- hh) Gazelona për transportimin e mbetjeve të vëllimshme të vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;
- ii) Makinë transportuese të kontenerëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundur ngarkimin dhe shkarkimin e kontenerëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë
- jj) Mjet special për pastrimin e reres dhe bregut të liqenit, e cila nëpërmjet thikave ben depertimin në rere jo më pak se 30 cm thellesi, dhe me performance jo më pak se 20.000 m<sup>2</sup> në orë dhe me depozite për transportimin e mbetjeve të vëllim jo më pak se 1.8 m<sup>3</sup>, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;
- kk) Mjet traktor i cili tërheq mjetin special për pastrimin e reres dhe bregut të liqenit me kapacitet tërheqës jo më pak se 125 KË, jo më pak se 1 (një) copë
- ll) Mjet borepastruese e cila duhet të jetë e kompletuar me pajisjet e pastrimit të bores dhe shpërndarjes së kripes, jo më pak se 1 (një) copë.
- mm) Makinë teknologjike kompakte e pajisur me mekanizem (Grejfer) për zbrazjen e kontejnerëve 3.2 m<sup>3</sup>. Kjo makineri duhet të jetë e shoqëruar me fotografi të saj në momentin e ngritjes dhe të zbrazjes të kontenerit të specifikuar në këtë pikë. (Kjo kërkohet për arsye se në qytetin e Pogradecit janë të vendosur rreth 15 kontejnerë të këtij lloji, të cilët mbajnë rreth 3 here me shumë mbeturina të kontenerit të zakonshëm), jo më pak se 1 (një) copë
- nn) Frezë pastrimi i trotuarëve nga dëbora, jo më pak se 2 (dy) copë.
- oo) Fshesë automatike me motor me djegie të brendshme e pajisur në sistem thithje për pastrimin e trotuarëve, jo më pak se 2 (dy) copë.
- pp) Fshesë automatike e pajisur me sistem thithës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 6 (Gjashtë) copë.
- qq) Mjet special për pastrimin e liqenit në thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo më pak se 1 (një) copë
- rr) Eskavatore me zinxhira, jo më pak se 2 (dy) copë
- Per Mjetet teknologjike të kerkuara në pikën 2.3.13, germa a - j, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
- a) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar).
- b) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe të shoqëruar nga dokumentacioni i plotë i cdo mjeti përkatës dhe foto të secilit mjet ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.
- Percaktimi nga ana e autoritetit kontraktor i vitit të prodhimit të makinerive është një kriter diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPPs se. Makinerite kollaudohe nga kompania "SGS Albania" e cila percakton nëse makina plotëson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave të motorit në ajër etj.,) sipas legjislacionit në fuqi për të qarkulluar në rruget e Republikës së Shqipërisë. Kur makinerite kollaudohe në baze të rregullave të percaktuara në

*Manualin e Kontrollit te Mjeteve nga shoqeria "SGS Albania" atehere keto makineri mund te perdoren ne Republiken e Shqiperise.*

*Vendosja e vitit te prodhimit nga autoriteti kontraktor si kusht skualifikimi eshte nje kriter diskriminues, i pabazuar ne VKMnr. 914, date 29.12.2014 dhe LPP. Kerkojme heqjen e ketij kriteri per vitin e prodhimit te mjeteve jo me pak se viti 2012. Te njejtin qendrim ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr. 748/2017.*

*Kerkesa e autoritetit kontraktor qe mjetet te cilat do te vihen ne dispozicion te ekzekutimit te kontrates te kene vit prodhimi 2012, ne rastin konkret eshte i ekzagjeruar, jopropocional dhe diskriminues pasi ndikon drejtperdrejt ne uljen e konkurrences ndermjet operateve ekonomike. Gjykojme se nese mjetet jane te pajisura me dokumentacionin e duhur dhe kane kaluar kontrollet teknike te nevojshme qe parashikon ligji jane ne gjendje te realizojne me sukses objektin e prokurimit. Autoriteti kontraktor nuk duhet te vendose kriteret te tepruara dhe qe nuk i sherbejne qellimit final te autoritetit kontraktor per nje realizim te sukseshem te kontrates. E rendesishme per autoritetin kontraktor eshte qe operateret ekonomike te zoterojne te gjitha kapacitete e nevojshme teknike ne rastin konkret llojin dhe numrin e mjeteve per ekzekutimin e kontrates. Cdo kriter tjetër qe tejkalon kete qellim eshte i ekzagjeruar dhe cenon konkurrencen ndermjet operateve ekonomike.*

*Autoriteti ka kerkuar provueshmerine e disponueshmerise se mjeteve ose me pronesi ose me qera. Ne formen e kerkuar nga ju te provimit te disponueshmerise se mjeteve parashikohet vetem pronesia ose marrja me qera (e cila ne konceptin juridik perfshin dy elemente te pronesise posedim dhe perdorim) nderkohe qe nuk keni dhene mundesine e disponueshmerise se mjeteve qe mund te vihen ne dispozicion me forma te ndryshme dhe konkretisht me ane te kontrates se porosise, parashikuar nga neni 914 i Kodit Civil ose kontratatave te blerjes se mjeteve me kusht (ne rast te shpalljes fitues) Nje praktike e ngjashme ndiqet nga shume autoritete kontraktore Madje, te njejtin qendrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin KPP 407/2018 ku thuhet se: "Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet te kufizohet vetem ne kerkesen per mjetet me qera ose ne pronesi ne kushte kur disponueshmeria e tyre mund le vertetohet edhe me Jorma le tjera, duke mos krijuar barriera e pengesa ne lidhje me kriterin per mjetet, por duke krijuar lehtësi per konkurrence te hapur per te gjithë operateret ekonomike te interesuar, te cilet kane disponueshmerine e mjeteve ne nje prej formave qe njeh legjislacioni ne fuqi. Ne rastin konkret, kur kemi te bejme me nje kontrate disavjecare, ne kuader te mosdiskriminimit dhe krijimit te lehtesirave per te gjithë operateret ekonomike te interesuar, autoriteti kontraktor duhet te beje modifikimin e kriterit, duke percaktuar disponueshmerine e mjeteve me te gjitha format e njohura nga legjislacioni perkates ne fuqi, ne varesi kjo te kontrates, zerave e volumeve te preveniivit, si edhe llojit dhe numrit te mjeteve te kerkuara. Per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme qe operateret ekonomik pjesemarres te provojne se disponojne kapacitetet teknike (makineri, pajisje etj) ne nje nga menytrat e percaktuara nga legjilacioni perkates, gjithcka ne funksion te permbushjes me sukses te kontrates."*

*Ne lidhje me mjetet: Mjet special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit, Freze pastrimi i trotuareve nga debora, Fshese automatike me motorr me djegie te brendshme e pajisur ne sistem thithje per pastrimin e trotuareve, jo me pak se 2 (dy) cope, Fshese automatike e pajisur me sistem thithes dhe me kosh per grumbullimin e mbeturinave, jo me pak se 6 (Gjashte) cope, Mjet special per pastrimin e liqenit ne thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri*

4 ton, jo me pak se 1 (nje) cope AK duhet te jete me e qarte dhe te percaktoje mire llojin e mjetit dhe specifikimet e ketyre mjeteve qe Operatoret Ekonomike pjesmares ti hartojne ofertat e tyre ne perputhje me ato mjete qe ju kerkoni. AK duhet te veje ne dispozicion te OE edhe modele te ketyre mjeteve pa percaktuar marke si dhe specifikimiet teknike. Kjo kerkese eshte e bazuar edhe ne LPP ku thuhet se Autoritetet Kontraktore duhet te hartojne kriteret sa me te qarta dhe konkrete. Kerkojme modifikim e kriterit duke hequr vitin e prodhimit te mjeteve dhe paraqitjen e mjeteve me Kontrate Porosie ose blerje me kusht, si dhe percaktimin sa me te sakte te mjeteve dhe paisjeve sebashku me Specifikimet Teknike te tyre.

8. Per mjetet ne pronesi/qera, Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pese) diteve nga mbyllja e dorezimit te ofertave rezervon te drejten e verifikimit te tyre. Ne kete deklarate do te jepen te dhena te sakta te kontaktit te operatorit ekonomik si: Numer cel, adrese emaili, adresa e selise se shoqerise. Nga ana e autoritetit kontraktor do te dergohet nje njoftim si ne adresen elektronike ne SPE edhe ne te dhenat e kontaktit te OE ku do te percaktohet vendi dhe ora e paraqitjes se mjeteve prane ambienteve te Bashkise Pogradec. Ne rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon te gjitha mjetet e deklaruar ne tender, ai do te s'kualifikohet. Gjithashtu ndryshimet qe mund te perkojne me te dhenat e mjetit te deklaruar dhe atyre qe te rezultojne nga verifikimi fizik i tyre do te perbej shkak per skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar.

Ky kriter i vendosur cenon fshehtesine e procesit si nje nga hallkat themelore te ketij Legjislacioni sepse KVO ose AK nuk duhet te kete asnje kontakt me Operatoret pjesmares deri ne perfundimin e vleresimit te ofertave. Duke ju referuar nenit 62 "Detyrimet gjate zbatimit te kontrates" te LPP, autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e sukseshem te kontrates. Sjellim ne vemendje se, referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e sherbimit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar.

Ne rastin konkret, ju si autoritet kontraktor po prokuroni nje sherbim me objekt per te cilen ka zgjedhur llojin e procedures "Procedure e Hapur" dhe jo sherbim konsulence, ne te cilen te gjykohet se cilin nga pjesmarresit ka dhene zgjidhjen me te favorshme apo me optimale lidhur me mjetet e propozuara. Paraqitja e kesaj Deklarate eshte e pavlefshme edhe ne rastin e mjeteve me kontrate porosie. Kerkojme qe ky kriter te hiqet.

9. Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te disponoje nje pike per larjen dhe dizinfektimin e kazaneve (lavazh) ne pronesi apo me qera (ne formen e kerkuar nga ligji, me certifikate pronesie nese eshte ne pronesi, me kontrate qeraje nese eshte marre me qera shoqeruar me dokumentacionin e perkates.

Ne lidhje me kete kriter duhet te hiqet nga Kriteret e Vecanta sepse Operatoret Pjesmares mund ta realizojne ne ambientet e Oficines qe ju keni kerkuar prej 1000 m<sup>2</sup> dhe mund te kerkoni vetem paisjet e lavazhit.

Kerkojme qe ta modifikoni kete kriter.

10. Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te paraqese dokumentin (aktmarreveshje apo kontrate mirembajtje) qe do te kryej sherbimin e mirembajtjes kazanave me subjektin qe do te riparoje kazanat e mbledhjes se mbeturinave. Se bashku me aktmarreveshjen apo kontraten e mirembajtjes duhet te paraqitet dhe dokumentacion provues qe ofruesi i sherbimit ka si aktivitetet e tij mirembajtjen e kazaneve.

Edhe per sa i perket keti kriteri Operatoret Ekonomike mund ta realizojne vete kete proces pune pa pasur nevojën e Subjekteve te profilizuara sepse ne dijenine tone nuk ka Subjekte qe merren me riparimin e konteniereve, por Operoret e realizojne vete prane Oficinave te tyre.

Prandaj kerkojme heqjen e ketij kriteri te panevojshem.

II.7. Në datën 22.01.2020, nëpërmjet shkresës nr. 08/4 Prot., datë 20.01.2020, me objekt “Në zbatim të Vendimit Nr.24/1 protokolli, datë 20.01.2020”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Korsel” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se “Pra AK nuk mund te percaktoje Profesionet e Drejtuesit Teknik.” [...] Kerkojme qe te hiqet Ing. Gjeodet nga kriteret sepse nuk eshte ne perpjestim me kontraten dhe sherbimet qe do te kryhen gjate zbatimit te kontrates.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.11 nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.2 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesit Teknik për Bashkinë Pogradec, të cilët duhet të figurojnë në licensën profesionale të shoqërisë (1 ndërtimi/mjedisi dhe 1 Gjeodet), të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

a) Libreze pune (përkatëse)

b) Diplomë

c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesit Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës.

d) Drejtuesit teknik duhet të figurojnë te punesuar prane shoqerise te pakten 12 muajt e fundit.

- e) *Minimalisht njëri prej drejtuesve teknik të shoqërisë të disponojë dëshmi trajnimit si "Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për drejtuesin teknik të shoqërisë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për "Për përgjegjësinë për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" e dhënë nga një organizim i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.*
- f) *Minimalisht njëri prej drejtuesve teknik të shoqërisë të disponojë dëshmi trajnimit për "Administrimin e Mbetjeve Urbane" e dhënë nga një organizim i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.*
- g) *Drejtuesit Teknik nuk duhet të figurojnë të dypunësuar. Si rrjedhojë OE duhet të lëshojë një deklaratë ku të specifikohet se drejtuesit teknik nuk janë të dypunësuar apo të angazhuar në ndonjë veprimtari tjetër jashtë OE pjesmarrës. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".*

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se: "1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: "b. aftësia teknike: operatorët ekonomikë vertetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

III.1.3. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 "Kontratat e Shërbimeve", e ndryshuar, përcaktohet se: "Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon"

- a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose*
- c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- ç) *dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare

përkatëse përsa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.1.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kriterëve të kualifikimit.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, për heqjen e kërkesës në lidhje me profesionin e drejtuesit teknik, KPP gjykon se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një procedurë prokurimi shërbimi të pastrimit të qytetit, kështu që rrjedhimisht kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me profesionet që duhet të disponojnë drejtuesit teknik është një kërkesë e ekzagjeruar dhe diskriminuese e cila nuk është në proporcion dhe në përputhje me objektin e prokurimit.

Pra sa më sipër, KPP gjykon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të kërkojë drejtues teknik, por autoriteti kontraktor nuk duhet të kufizojë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, duke përcaktuar dhe profesionin konkret që duhet të ketë secili prej tyre. Pra, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke hequr përcaktimin në lidhje me profesionin e drejtuesve teknik.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Korsel” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se “*Ne lidhje me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me 2 Inxhinier Mekanik, te punesuar mendojme qe eshte kriter diskriminues I cili nuk ka asnje lidhje me natyren e punimeve qe do te kryhen. Argumentimi se duke qene nje numer i madh mjetesh teknologjike te cilat do te vihen ne dispozicion per realizimin e kontrates te cilat ne rast defekti kerkojne njohuri ne nivelin inxhinierik eshte i pabazuar ne ligj dhe ne fakt duke diskriminuar operatoret ekonomike dhe duke ulur konkurrencen. Inxhinieret mekanik te punesuar prane shoqerive nuk mundet ne asnje rast logjikisht dhe ligjerisht te bejne rregullimin e defekteve te mjeteve riparimi i te cilave mund te behet vetem ne subjekte juridike te kualifikuara dhe te licencuara referuar akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi. Pra theksojme se eshte ligjerisht e pamundur qe nje inxhinier mekanik punesuar prane shoqerise te beje riparim te defekteve te mjeteve teknologjike duke qene I palicencuar per te ushtruar kete veprimtari. Kerkojme qe kjo pike te rishikohet*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3 nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.3 *Kandidati ofertues duhet te kete te punesuar dy Inxhinier Mekanik, të cilët të kenë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet, si dhe te figurojne te punesuar prane shoqerise te pakten 6 muajt e fundit shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:*

- a) *Librezë pune (përkatëse)*
- b) *Diplomë*
- c) *Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)*

III.2.2. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.13 dhe 2.3.14 nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*

- a) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 3 (tre) copë;*
- b) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 7-10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 4 (kater) copë;*
- c) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me fshesa anësore , sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012 jo më pak se 1 (një) copë;*
- d) *Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 2 (dy) copë;*
- e) *Gazelona per trasnportimin e mbetjeve te vellimshme e vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*



- f) *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë*
- g) *Mjet special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit, e cila nepermjet thikave ben depertimin ne rere jo me pak se 30 cm thellesi, dhe me performance jo me pak se 20.000 m2 ne ore dhe me depozite per transportimin e mbetjeve me vellim jo me pak se 1.8 m3, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*
- h) *Mjet traktor i cili terheq mjetin special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit me kapacitet tërheqës jo me pak se 125 KË, jo më pak se 1 (një) copë*
- i) *Mjet borepastruese e cila duhet te jete e kompletuar me pajisjet e pastrimit te bores dhe shperndarjes se kripes, jo më pak se 1 (nje) copë.*
- j) *Makine teknologjike kompaktore e pajisur me mekanizem (Grejfer) per zbrazjen e kontenjereve 3.2 m<sup>3</sup>. Kjo makineri duhet te jete e shoqeruar me fotografi te saj ne momentin e ngritjes dhe te zbrazjes te kontenierit te specifikuar ne kete pike. (Kjo kerkohet per arsye se ne qytetin e Pogradecit jane te vendosur rreth 15 konteniere te ketij lloji, te cilet mbajne rreth 3 here me shume mbeturina se kontenieret e zakonshem), jo më pak se 1 (një) copë*
- k) *Frezë pastrimi i trotuareve nga dëbora, jo më pak se 2 (dy) copë.*
- l) *Fshesë automatike me motorr me djegie të brendshme e pajisur ne sistem thithje për pastrimin e trotuarëve, jo më pak se 2 (dy) copë.*
- m) *Fshesë automatike e pajisur me sistem thithës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 6 (Gjashte) copë.*
- n) *Mjet special per pastrimin e liqenit ne thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo më pak se 1 (një) copë*
- o) *Eskavatore me zinxhira, jo më pak se 2 (dy) copë*

*2.3.14 Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 2.3.13, gërma a – j, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- a) *Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar).*
- b) *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe e shoqëruar nga dokumentacioni i plotë i cdo mjeti përkatës dhe foto të secilit mjet ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.*
- c) *Për mjetet qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; kontratën përkatëse të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- d) *Per mjetet e tjera te cilat nuk shenohen ne regjistrat publike, pronesi/qera duhet te paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore perkatese ose cdo dokument tjetër sipas legjislacionit Shqiptar ne fuqi, te cilat vertetojne posedimin e mjeteve ose pajisjeve.*

- e) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.*
- f) *Për mjetet në pronësi/qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga mbyllja e dorëzimit të ofertave rezervon të drejtën e verifikimit të tyre. Në këtë deklaratë do të jepen të dhëna të sakta të kontaktit të operatorik ekonomik si : Numër cel, adresë emaili, adresa e selisë së shoqërisë. Nga ana e autoritetit kontraktor do të dërgohet një njoftim si në adresën elektronike në SPE edhe në të dhënat e kontaktit të OE ku do të përcaktohet vendi dhe ora e paraqitjes së mjeteve pranë ambienteve të Bashkisë Pogradec. Në rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon të gjitha mjetet e deklaruar në tender, ai do të s'kualifikohet. Gjtihashtu ndryshimet që mund të përkoojnë me të dhënat e mjetit të deklaruar dhe atyre që të rezultojnë nga verifikimi fizik i tyre do të përbëj shkak për skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.*
- g) *Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet të disponojë një mjedis në pronësi ose me qira brenda territorit të Bashkisë Pogradec te pakten 1000 m2 truall dhe te pakten 100 m2 ndertese per zhvillimin e ketij aktiviteti per punonjesit dhe stafin drejtues (ne formen e kerkuar nga ligji, me çertifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontrate qeraje pranë zyrës noteriale nëse është marrë me qera e shoqeruar me certifikaten e pronesise te qiradhenesit)*
- h) *Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te disponoje nje pike per larjen dhe dizinfektimin e kazaneve (lavazh) ne pronesi apo me qera (ne formen e kerkuar nga ligji, me çertifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontrate qeraje nëse është marrë me qera shoqeruar me dokumentacionin e përkatës*
- i) *Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te paraqese dokumentin(aktmarreveshje apo kontrate mirembajtje) qe do te kryej sherbimin e mirembajtjes kazanave me subjektin qe do te riparoje kazanat e mbledhjes se mbeturinave. Se bashku me aktmarreveshjen apo kontraten e mirembajtjes duhet te paraqitet dhe dokumentacion provues që ofruesi i sherbimit ka si aktivitet te tij mirembajtjen e kazaneve*
- j) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet : «Specifikime Teknike », të firmosuar e vulosura dhe grafikun e kryerjes së shërbimit të pastrimit sipas afateve të përcaktuara në specifikimet teknike.*

III.2.3. Në nenin 46 pika.1, gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.2.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve”, e ndryshuar, përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislationin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.2.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kriterëve të kualifikimit.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: “2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në rastin konkret, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të inxhinierit mekanik,

III.2.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për kualifikim nuk duhet të japë kërkesa në tejkalim të objektit, natyrës dhe llojit të procedurës që prokurohet, por duhet të përcaktojë kriterë jo diskriminuese, të cilat nuk pengojnë konkurrencën e lirë, dhe janë gjithpërfshirëse duke lejuar pjesëmarrjen edhe të biznesit të vogël, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastin konkret, KPP gjykon se, referuar llojit të procedurës së prokurimit, vlerës së saj, numrit të konsiderueshëm të mjeteve të kërkuara për realizimin e kësaj procedure, si dhe ofrimit të shërbimit për një kohë të gjatë dhe të pandërprerë, KPP gjykon se kërkesa e vendosur nga autoriteti kontraktor për inxhinierin mekanik është një kërkesë e drejtë. Theksojmë se, qëllimi i kësaj procedure prokurimi është realizimi me sukses dhe në kohe i shërbimit të pastrimit të qytetit dhe moskrijimi i një situatë konfuze dhe kaotike, në kushtet kur kërkohet një shërbim i pandërprerë i pastrimit, për të cilin nuk mund të tolerohet mosfunksionimi i mjeteve dhe pajisjeve, kështu që rrjedhimisht kërkesa për inxhinierin mekanik është një kërkesë e domosdoshme dhe që i shërben zhvillimit me cilësi dhe në kohë të shërbimit për të cilin do të zhvillohet kjo procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Korsel” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se *“Ne lidhje me kriterin e mesiperm ku AK shprehet se Ing. Agronom duhet te disponoje Licence Profesionale Sherbimi ne Zbatim leshuar nga Komisioni i Dhenies se licensave Profesionale ku te kete te perfshire kategorine 14 B (Pastrimi i Siperfaqeve Urbane) ju bejme me dije se keni ngushtuar kriteri vetem te ING Agronom kur ne VENDIMIN NR.412, DT 15.9.1992 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER KRIJIMIN E KOMISIONIT TE POSACEM PER DHENIEN E LICENCAVE PROFESIONALE", shprehet qarte se licenen Profesionale perfshire kategorine 14 B (Pastrimi i siperfaqeve urbane) mund ta disponoje cilido person qe verteton se ka mbaruar minimumi nje shkolle te larte te cfaredo lloje dege. Argumentimi qe autoriteti kontraktor ben se liqeni ka bimesi ujore dhe rreth 22 lloje peshqish te cilet mund te demtohen nga procesi i pastrimit sikunder eshte parashikuar ne specifikimet teknike nuk ka asnje baze dhe per me teper kontrollin e ketij procesi nuk mund ta beje kurrsesi nje inxhinier agronom.Prandaj nga sa thame me siper ky kriter te ndryshohet.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5 nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.5. Kandidati ofertues duhet te kete te punesuar Inxhinier Agronom, të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet, si dhe te figuroje i/e punesuar prane shoqerise te pakten 6 muajt e fundit shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune (përkatëse)
- b) Diplomë
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme)
- d) Te disponoje License Profesionale Sherbimi ne Zbatim leshuar nga Komisioni i Dhenies se licensave Profesionale ku te kete te perfshire kategorine 14 b (Pastrimi i siperfaqeve urbane)

III.3.2. Në nenin 46 pika.1, gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.3.3. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve”, e ndryshuar, përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjisllacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.3.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi,

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kriterëve të kualifikimit.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”*

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në rastin konkret, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të inxhinierit të agronom, në kushtet kur objekti i kontratës është pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në tejkallim të kontratës objekt prokurimi dhe të dispozitave ligjore përkatëse mbi prokurimet, duke patur parasysh dhe zërat e parashikuara në preventivin e shërbimeve që do të kryhen. Komisioni gjykon se kërkesa sa më sipër e autoritetit kontraktor, duhet modifikuar, duke hequr inxhinierin agronom.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“4. Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur nga Qendra Kombetare e Licensimit me; Leje Mjedisore të leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit me kod III.1.A për pastrim larje sprucim kontinieresh në mënyrë që të riperdoren.*

*Ne lidhje me kërkesën e mesiperme, sqarojme se referuar ligjit në fuqi nuk leshohet leje mjedisore kodi III.1.A me objekt (pastrim larje sprucim kontinierest në mënyrë që të riperdoren), pasi nuk ekziston asnjë leje e tillë me këte pershkrim [...]”. Si dhe pretendimin se “5. Leje mjedisore Tipi C me Kod III.1.A të leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit për Riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave. Kriteri i vendosur nga AK është teresisht i jashtë ligjshëm dhe nuk gjen baze*

ne aktivitetin e Sherbimit Objekt Prokurimi dhe si i tille duhet te hiqet sepse ne asnje nga zerat e preventivit nuk kemi te bejme me riparim mjetesh. Ky eshte nje aktivitet te cilin Operatoret mund ta realizojne nepermjet Operatoreve qe e ofrojne kete sherbim dhe mund te jene te licencuar. Ne VKM 914 te RrPP Nenin 28 pika 2 shprehet qarte se: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese natyren dhe vleren e kontrates". Prandaj kerkojme qe ky kriter te hiqet si i pa bazuar ne Ligj dhe VKM..." Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, shtojca 8, pika 2.3.11, "Kapaciteti teknik", nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

- Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me kod III.1.A për pastrim larje sprucim kontinieresh në mënyrë që të ripërdoren.
- Leje mjedisore me Kod III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me objekt stacion transferimi.
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Ndikimin në Mjedis (kodi III.2.A)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullimin dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbime ndërhyrëse higjeno-sanitare (kodi II.8.B)
- Leje mjedisore Tipi C me Kod III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave.

III.4.2. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet se: "[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

III.4.3. Në nenin 28 pika 5 gërma "a" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

"5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose."

III.4.4. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", në nenin 1 dhe 2 "Qëllimi dhe Objekti", parashikohet shprehimisht:

"Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës".

Ky ligj përcakton:

a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

*b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”*

III.4.5. Në neni 4 “Sistemi i lejeve të mjedisit” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, parashikohet shprehimisht:

*“1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:*

*a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/A të këtij ligji;*

*b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji;*

*c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/C të këtij ligji.”*

III.4.6. Në shtojcën 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, përcaktohet:

*”Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti **kufi** nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo. [...]*

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse për sa i përketë rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkualuar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Refruar sa më sipër, Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me

III.4.7. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, si dhe nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar “Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me kod III.1.A për pastrim larje sprucim kontinieresh në mënyrë që të ripërdoren” si dhe “Leje mjedisore Tipi C me Kod III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit per Riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave”. Sa më sipër, KPP gjykon se, lejet e mjedisit të kërkuara në kriterin e mësipërm nga autoriteti kontraktor, kanë si objekt, pjesë (zëra të preventivit) të shërbimit që



kërkohe të prokurohet. Pra, autoriteti kontraktor, nuk mund të kërkojë leje mjedisore për cdo zë të preventivit të shërbimeve që kërkohe të realizohet, por duhet të përcaktojë kriterin duke u bazuar në objektin e përgjithshëm të prokurimit. Për sa kohë objekti i procedurës së mësipërme të prokurimit është pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave, rrjedhimisht dhe kërkesa për leje mjedisore duhet të hartohet në përputhje me këtë objekt.

Për këto arsye, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, në lidhje me disponimin “Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit me kod III.1.A për pastrim larje sprucim kontinieresh në mënyrë që të ripërdoren” si dhe “Leje mjedisore Tipi C me Kod III.1.A të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Riparim i pajisjeve motorrike dhe motocikletave”, nuk është aspak i lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve në pikën 2 të nenit 30, të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, por duhet të modifikohet duke kërkuar leje mjedisore në përputhje me objektin e përgjithshëm që kërkohe të prokurohet.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Korsel” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se “Operatori ekonomik duhet të paraqese license profesionale të Shoqërisë, sipas modelit të lëshuar nga MPPTT ose MTI e vlefshme, për kategorite si mëposhte:

1. NP-12 A (punime të inxhinierise së mjedisit)
2. NP-9 A (Punime dhe mbrojtje lumore)
3. NS-18 A (Punime Topogjeodezike).

Edhe kriteri i mesiperm nuk është në përpjestim ose i lidhur ngushtë me objektin dhe me shërbimet që do të kryhen sepse kategorite e Licences së Zbatimit NP 9 dhe NS 18 kryejnë ekzaktesisht punimet e mëposhtme. Pasi analizuam me kujdes, preventivin dhe specifikimet teknike të publikuara në APP për këtë objekt tenderi, konstatojmë se zerat e punimeve të përcaktuara në preventiv konsistojnë në fshirje rruges, mirembajtje rruges, ngarkim mbeturinash, pastrim plazhi, bregu liqenit, dizifektim kontinieresh, lagje rruges, mirembajtje lumi, pastrim I thelle lumenjsh, lysterje kontinieresh, pastrim moli I qytetit, larje rruges, pastrim nga bora e kriposje. Mbeshtetur në vendimit nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet përkatëse caktohen duke u mbështetur në punimet e parashikuara në preventivin e objektit dhe në vlerën totale të punimeve për secilën kategori.

Në lidhjen Nr.3 përcaktohet:

N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

Konsiderohen ndertime, mirembajtje ose ristrukturime me nderhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrore ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujera, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykederdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të aneve të lumeneve dhe perrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e

rregjimit hidraulik te ujerave siperfaqesore te veprave te diafrangmave te argjinaturave dhe qendrueshmerise se shpateve.

Sic rezulton kategoria NP-9 mund te kerkohet vetem kur ne preventivm e percaktuar per realizimin e ketij sherbimi, jane parashikuar punime qe permbledh kjo pike, sic edhe i parashtruam me lart dhe ne asnje rast tjeter qe nuk perfshihet ketu nuk mund te kerkohet nje pike e tille. Po te rikthehemi te sherbimet e kerkuara te realizohen ne preventivin e dhene nga autoriteti kontraktor nuk gjejme asnje ze punimi qe te perputhet me punimet qe permbledhe NP- 9. Sqarojme se Kategoria NP-9 parashikon sisteme hidraulike dhe bonifikime dhe punime per mbrojtje lumore te cilat nuk kane asnje lidje me realizimin e sherbimit object I kesaj kontrate. Ne kushtet, kur ky kriter eshte vendosur ne kundershtrim me parashikimet ligjore kerkojme heqjen e ketij kriteri.

NS-18 C (Punime Top gjeodezike), nderkohe qe ne Lidhjen Nr.2 te vendimit nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", percaktohet :

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale qe kerkojne mjete dhe organizim te vecante, punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbeshtetese dhe qendrueshmeri terrenesh.

Sic rezulton kategoria NS-18 mund te kerkohet vetem kur ne preventivm e percaktuar per realizimin e ketij sherbimi, jane parashikuar punime qe permbledh kjo pike, sic edhe i parashtruam me lart dhe ne asnje rast tjeter qe nuk perfshihet ketu nuk mund te kerkohet nje pike e tille. Po te rikthehemi te sherbimet e kerkuara te realizohen ne preventivin e dhene nga autoriteti kontraktor nuk gjejme asnje ze punimi qe te perputhet me punimet qe permbledhe NS-18. Ky kriter eshte diskriminues ne kundershtrim nuk eshte ne proporcion me natyren e kontrate duke mos patur asnje rol ne realizimin e sherbimit per kete arsye kerkojme heqjen e ketij kriteri. [...].

Prandaj te dy pikat NP 9 dhe NS 18 te hiqen sepse jane te pa bazuara ne Ligj dhe jane diskriminuese per Operatoret Ekonomike.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, "Kapaciteti teknik", pika 2.3.12 nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensë profesionale të Shoqërisë, sipas modelit të lëshuar nga MPPTT ose MTI e vlefshme, për kategoritë si mëposhte:

1. NP-12 A (punime te inxhinierise se mjedisit)
2. NP-9 A (Punime dhe mbrojtje lumore)
3. NS-18 A (Punime Topogjeodezike).

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

III.5.2. Në dokumentat e tenderit Shtojca 1 "Formulari i ofertës" është kërkuar: Objekti:

Objekti: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TE QYTETIT POGRADEC

1. Fshirje siperfaqe te asfaltuara me fshese dore naten
2. Fshirje siperfaqe te asfaltuara me makineri

3. Mirmbajtje rrugesht qyteti ditën
4. Ngarkim + Transport mbeturinash familjare dhe mbeturina plazhi
5. Pastrim plazhi nga mbeturinat+Plugim dhe lesim+pastrim bregu I liqenit nga algat me mjet special te posacem I pajisur me traktor terheqes
6. Ngarkim + transport te ngurtash (inerte) ne qytet
7. Dizinfektimi i konteniervë me gelqere dhe klor dhe larja e pikave te vendgrumbullimit njehere ne jave
8. Lagie dhe freskim rrugesht (2 here/dite)
9. Mirembajtje lumi i qytetit dhe lumit te Verdoves
10. Pastrim I thelle lumenjsh me eskavatore+ transport inertesh (lumi I qytetit dhe lumi Verdoves)
11. Lyerje kontenierësh+Mirembajtje dhe larje kazanesh
12. Pastrim I molit te qytetit nga mbetjet vajore te mjeteve motorrike ne uje
13. Pastrim me mjet te posacem te leshterikeve ne thellesi here
14. Larje speciale e disa shesheve ne qytet me uje me presion 1 here ne jave ( 4 here ne muaj
15. Pastrim nga bora dhe kriposje
16. Blerje Kazane te rinj

Objekti: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TE Njeisve administrative Udenisht

1. Fshirje sipërfaqe te asfaltuara me fshese dore naten
2. Mirmbajtje rrugesht ditën
3. Ngarkim + Transport mbeturinash familjare
4. Ngarkim + transport te ngurtash
5. Dizinfektimi i konteniervë
6. Lagie dhe freskim rrugesht (1 here ne dite)
7. Pastrim i thelle lumenjsh me eskavator+ transport lumi Gur I Kuq dhe lumi i Memelisht

Objekti: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TE Njeisve administrative Bucimas

1. Fshirje sipërfaqe te asfaltuara me fshese dore naten
2. Mirmbajtje rrugesht ditën
3. Ngarkim + Transport mbeturinash familjare
4. Ngarkim + transport te ngurtash
5. Dizinfektimi i konteniervë
6. Lagie dhe freskim rrugesht (1 here ne dite)
7. Mirembajtje lumi Rremenj dhe lumi Guras
8. Pastrim i thelle lumenjsh me eskavator+ transport lumi Rremenj dhe lumi Guras

Objekti: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TE Njeisve administrative Cerrave + Darsdhas

1. Ngarkim + Transport mbeturinash familjare
2. Ngarkim + transport te ngurtash
3. Dizinfektimi i konteniervë
4. Mirembajtje lumi Cerrave
5. Pastrim i thelle lumenjsh me eskavator+ transport lumi Cerrave

Objekti: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TE Njeisve administrative Velcan, Trebinje, Proptisht

1. Ngarkim + Transport mbeturinash familjare Velcan (2 here ne jave)
2. Ngarkim + Transport mbeturinash familjare Trebinje (2 here ne jave)
3. Ngarkim + Transport mbeturinash familjare Proptisht (2 here ne jave)

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, germat “a” e “b” e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.5.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve”, e ndryshuar, përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

III.5.5. Në nenin 28/2 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.5.6. Në VKM-në nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridikë, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar, Kreu I “Qëllimi fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime” parashikon se: Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësive që ka subjekti i pajisur me licencë. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë

*pavarësisht formës së organizimit të tij. Subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm me subjekte të licencuar, sipas kësaj rregulloreje. [...]*

*Në lidhjen 3 parashikohet se: [...] N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimin të kompaktësimin të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimin natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekulibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrerave dhe mbetjeve inerte.*

*N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemin dhe vendosjen e rregjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafrangmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.*

*N.S – 18 Punime topogjeodezike*

*Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

III.5.7. Në rastin konkret, objekti i prokurimit është "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe Njësisve Administrative", nisur edhe nga zërat e preventivit si edhe nga vlera e objektit të prokurimit, autoriteti kontrator kërkon të krijojë një panoramë të përgjithshme për verifikimin e kapaciteteve të shoqërive pjesëmarrëse, të cilët duhet të vërtetojnë se disponojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm, në lidhje me kategoritë e licencës konkretisht: N.P. 9 A, referuar bazës ligjore të sipërcituar si dhe shtojcës Preventiv pa çmime, të dokumentave të tenderit, ku parashikohet realizimi i zërave si mirëmbajtje dhe pastrim i thellë lumenjsh, është një kërkesë e domosdoshme dhe në përputhje me objektin e prokurimit. Ndërkohë që për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimes për heqjen e kriterit në lidhje me pikën e licencës N.S.18 A, KPP gjykon se referuar dokumentave të tenderit dhe zërave të preventivit të shërbimit, kërkesa për disponimin e kategorisë së licencës N.S.18 A, është një kërkesë e ekzagjeruar, jo në proporcion me objektin e prokurimit dhe nuk i shërben qëllimit të realizimit të këtij shërbimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron pjesërisht.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- a) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 3 (tre) copë;*
- b) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 7-10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 4 (kater) copë;*
- c) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me fshesa anësore , sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012 jo më pak se 1 (një) copë;*
- d) *Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 2 (dy) copë;*
- e) *Gazelona per transportimin e mbetjeve te vellimshme e vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*
- f) *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë*
- g) *Mjet special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit, e cila nepermjet thikave ben depertimin ne rere jo me pak se 30 cm thellesi, dhe me performance jo me pak se 20.000 m2 ne ore dhe me depozite per transportimin e mbetjeve me vellim jo me pak se 1.8 m3, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*
- h) *Mjet traktor i cili terheq mjetin special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit me kapacitet tërheqës jo me pak se 125 KË, jo më pak se 1 (një) copë*
- i) *Mjet borepastruese e cila duhet te jete e kompletuar me pajisjet e pastrimit te bores dhe shpërndarjes se kripes, jo më pak se 1 (nje) copë.*
- j) *Makine teknologjike kompaktore e pajisur me mekanizem (Grejfer) per zbrazjen e kontenjereve 3.2 m<sup>3</sup>. Kjo makineri duhet te jete e shoqeruar me fotografi te saj ne momentin e ngritjes dhe te zbrazjes te kontenierit te specifikuar ne kete pike. (Kjo kerkohet per arsye se ne qytetin e Pogradecit jane te vendosur rreth 15 konteniere te ketij lloji, te cilet mbajne rreth 3 here me shume mbeturina se kontenieret e zakonshem), jo më pak se 1 (një) copë*
- k) *Frezë pastrimi i trotuareve nga dëbora, jo më pak se 2 (dy) copë.*
- l) *Fshesë automatike me motorr me djejie të brendshme e pajisur ne sistem thithje për pastrimin e trotuarëve, jo më pak se 2 (dy) copë.*
- m) *Fshesë automatike e pajisur me sistem thithës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 6 (Gjashte) copë.*
- n) *Mjet special per pastrimin e liqenit ne thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo më pak se 1 (një) copë*
- o) *Eskavatore me zinxhira, jo më pak se 2 (dy) copë*

*Per Mjetet teknologjike te kerkuara ne piken 2.3.13, germa a - j, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: [...]*

*Percaktimi nga ana e autoritetit kontraktor i vitit te prodhimit te makinerive eshte nje kriter diskriminues dhe eshte ne kundeshim me nenin 1 dhe 2 te LPPs se. Makinerite kolaudohen nga kompania "SGS Albania" e cila percakton nese makina ploteson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave te motorit ne ajer etj.) sipas legjislacionit ne fuqi per te qarkulluar ne rruget e Republikes se Shqiperise. Kur makinerite kolaudohen ne baze te rregullave te percaktuara ne Manualin e Kontrollit te Mjeteve nga shoqeria "SGS Albania" atehere keto makineri mund te perdoren ne Republiken e Shqiperise. Vendosja e vitit te prodhimit nga autoriteti kontraktor si kusht skualifikimi eshte nje kriter diskriminues, i pabazuar ne VKMnr. 914, date 29.12.2014 dhe LPP. Kerkojme heqjen e ketij kriteri per vitin e prodhimit te mjeteve jo me pak se viti 2012. Te njejtin qendrim ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr. 748/2017.*

*[...].*

*Autoriteti ka kerkuar provueshmerine e disponueshmerise se mjeteve ose me pronesi ose me qera. Ne formen e kerkuar nga ju te provimit te disponueshmerise se mjeteve parashikohet vetem pronesia ose marrja me qera (e cila ne konceptin juridik perfshin dy elemente te pronesise posedim dhe perdorim) nderkohe qe nuk keni dhene mundesine e disponueshmerise se mjeteve qe mund te vihen ne dispozicion me forma te ndryshme dhe konkretisht me ane te kontrates se porosise, parashikuar nga neni 914 i Kodit Civil ose kontratatave te blerjes se mjeteve me kusht (ne rast te shpalljes fitues). [...]*

*Ne lidhje me mjetet: Mjet special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit, Freze pastrimi i trotuareve nga debora, Fshese automatike me motorr me djegie te brendshme e pajisur ne sistem thithje per pastrimin e trotuareve, jo me pak se 2 (dy) cope, Fshese automatike e pajisur me sistem thithes dhe me kosh per grumbullimin e mbeturinave, jo me pak se 6 (Gjashte) cope, Mjet special per pastrimin e liqenit ne thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo me pak se 1 (nje) cope AK duhet te jete me e qarte dhe te percaktoje mire llojin e mjetit dhe specifikimet e ketyre mjeteve qe Operatoret Ekonomike pjesmares ti hartojne ofertat e tyre ne perputhje me ato mjete qe ju kerkoni. AK duhet te veje ne dispozicion te OE edhe modele te ketyre mjeteve pa percaktuar marke si dhe specifikimet teknike. [...] Kerkojme modifikim e kriterit duke hequr vitin e prodhimit te mjeteve dhe paraqitjen e mjeteve me Kontrate Porosie ose blerje me kusht, si dhe percaktimin sa me te sakte te mjeteve dhe paisjeve sebashku me Specifikimet Teknike te tyre.”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.6.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.13 dhe 2.3.14 nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- p) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 3 (tre) copë;*
- q) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 7-10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 4 (kater) copë;*

- r) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, te pajisura me fshesa anësore , sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012 jo më pak se 1 (një) copë;*
- s) *Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 2 (dy) copë;*
- t) *Gazelona per trasnportimin e mbetjeve te vellimshme e vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*
- u) *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë*
- v) *Mjet special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit, e cila nepermjet thikave ben depertimin ne rere jo me pak se 30 cm thellesi, dhe me performance jo me pak se 20.000 m2 ne ore dhe me depozite per transportimin e mbetjeve me vellim jo me pak se 1.8 m3, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2012, jo më pak se 1 (një) copë;*
- w) *Mjet traktor i cili terheq mjetin special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit me kapacitet tërheqës jo me pak se 125 KË, jo më pak se 1 (një) copë*
- x) *Mjet borepastruese e cila duhet te jete e kompletuar me pajisjet e pastrimit te bores dhe shperndarjes se kripes, jo më pak se 1 (nje) copë.*
- y) *Makine teknologjike kompaktore e pajisur me mekanizem (Grejfer) per zbrazjen e kontenjereve 3.2 m<sup>3</sup>. Kjo makineri duhet te jete e shoqeruar me fotografi te saj ne momentin e ngritjes dhe te zbrazjes te kontenierit te specifikuar ne kete pike. (Kjo kerkohet per arsye se ne qytetin e Pogradecit jane te vendosur rreth 15 konteniere te ketij lloji, te cilet mbajne rreth 3 here me shume mbeturina se kontenieret e zakonshem), jo më pak se 1 (një) copë*
- z) *Frezë pastrimi i trotuareve nga dëbora, jo më pak se 2 (dy) copë.*
- aa) *Fshesë automatike me motorr me djegie të brendshme e pajisur ne sistem thithje për pastrimin e trotuarëve, jo më pak se 2 (dy) copë.*
- bb) *Fshesë automatike e pajisur me sistem thithës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 6 (Gjashte) copë.*
- cc) *Mjet special per pastrimin e liqenit ne thellesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo më pak se 1 (një) copë*
- dd) *Eskavatore me zinxhira, jo më pak se 2 (dy) copë*

2.3.14 Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 2.3.13, gërma a – j, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- k) *Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar).*
- l) *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe e shoqëruar nga dokumentacioni i plotë i cdo mjeti përkatës dhe foto të secilit mjet ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.*
- m) *Për mjetet qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - çertifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit.*



*Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; kontratën përkatëse të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*

- n) Per mjetet e tjera te cilat nuk shenohen ne regjistrat publike, pronesi/qera duhet te paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore perkatese ose cdo dokument tjetër sipas legjislacionit Shqiptar ne fuqi, te cilat vertetojne posedimin e mjeteve ose pajisjeve.*
- o) Operatori ekonomik duhet të paraqesë **foto** për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.*
- p) Për mjetet në pronësi/qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga mbyllja e dorëzimit të ofertave rezervon të drejtën e verifikimit të tyre. Në këtë deklaratë do të jepen të dhëna të sakta të kontaktit të operatorit ekonomik si : Numër cel, adresë emaili, adresa e selisë së shoqërisë. Nga ana e autoritetit kontraktor do të dërgohet një njoftim si në adresën elektronike në SPE edhe në të dhënat e kontaktit të OE ku do të përcaktohet vendi dhe ora e paraqitjes së mjeteve pranë ambienteve të Bashkisë Pogradec. Në rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon të gjitha mjetet e deklaruara në tender, ai do të s'kualifikohet. Gjithashtu ndryshimet që mund të përkoojnë me të dhënat e mjetit të deklaruar dhe atyre që të rezultojnë nga verifikimi fizik i tyre do të përbëj shkak për skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.*
- q) Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet të disponojë një mjedis në pronësi ose me qira brenda territorit të Bashkisë Pogradec te pakten 1000 m2 truall dhe te pakten 100 m2 ndertese per zhvillimin e ketij aktiviteti per punonjesit dhe stafin drejtues (ne formen e kerkuar nga ligji, me certifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontrate qeraje pranë zyrës noteriale nëse është marrë me qera e shoqeruar me certifikaten e pronesisë te qiradhenesit)*
- r) Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te disponoje nje pike per larjen dhe dizinfektimin e kazaneve (lavazh) ne pronesi apo me qera (ne formen e kerkuar nga ligji, me certifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontrate qeraje nëse është marrë me qera shoqeruar me dokumentacionin e përkatës*
- s) Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te paraqese dokumentin(aktmarreveshje apo kontrate mirembajtje) qe do te kryej sherbimin e mirembajtjes kazanave me subjektin qe do te riparoje kazanat e mbledhjes se mbeturinave. Se bashku me aktmarreveshjen apo kontraten e mirembajtjes duhet te paraqitet dhe dokumentacion provues që ofruesi i sherbimit ka si aktivitet te tij mirembajtjen e kazanave*
- t) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet : «Specifikime Teknike », të firmosura e vulosura dhe grafikun e kryerjes së shërbimit të pastrimit sipas afateve të përcaktuara në specifikimet teknike.*

III.6.2. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët

*ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.6.3. Neni 26, pika 8, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.6.4. Referuar Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet: c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.*

III.6.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Kërkesa e autoritetit kontraktor që mjetet të cilat do të vihen në dispozicion të ekzekutimit të kontratës të kenë vit prodhimi jo më poshtë se 2012, në rastin konkret është i ekzagjeruar, joproporcional dhe diskriminues pasi ndikon drejtpërdrejt në uljen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. KPP gjykon se nëse mjetet janë të pajisura me dokumentacionin e duhur dhe kanë kaluar kontrollet teknike të nevojshme që parashikon ligji janë në gjendje të realizojnë me sukses objektin e prokurimit. KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret të tepruara dhe që nuk i shërbejnë qëllimit final të autoritetit kontraktor për një realizim të suksesshëm të kontratës. E rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë të zotërojnë të gjitha kapacitete e nevojshme teknike në rastin konkret llojin dhe numrin e mjeteve për ekzekutimin e kontratës. Çdo kriter tjetër që tejkalon këtë qëllim është i ekzagjeruar dhe cënon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me vitin e prodhimit qëndron.

III.6.6. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues përse i përket disponueshmërisë së mjeteve, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të kufizohet vetëm në kërkesën për mjetet me qera ose në pronësi, në kushtet kur disponueshmëria e tyre mund të vërtetohet edhe me forma të tjera të parashikuara nga legjislati në fuqi, duke mos krijuar barriera e pengesa në lidhje me kriterin për mjetet, por duke krijuar lehtësi për konkurrencë të hapur për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të cilët kanë disponueshmërinë e mjeteve në një prej formave që njih legjislati në fuqi. Në rastin konkret, kur kemi të bëjmë me një kontratë disavejeçare dhe

konkretisht referuar kohëzgjatjes së kontratës kemi të bëjmë me një shërbim 5-vjeçar të shtrirë në kohë, me qëllim mospenalizimin e tyre, si edhe në kuadër të mosdiskriminimit dhe krijimit të lehtësirave për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit duke përcaktuar disponueshmërinë e mjeteve me të gjitha format e njohura nga legjislacioni përkatës në fuqi, në varësi kjo të kontratës, zërave të preventivit, si edhe llojit dhe numrit të mjeteve të kërkuara, si edhe të bëjë formulimin e tij pa shkaktuar konfuzion, si tek operatorët ekonomikë gjatë hartimit të ofertës së tyre, ashtu edhe tek autoriteti kontraktor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatorët ekonomik pjesëmarrës të provojnë se disponojnë kapacitetet teknike (makineri, pajisje etj) në një nga mënyrat e përcaktuara nga legjilacioni përkatës, gjithçka në funksion të përmbushjes me sukses të kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.6.7. Për sa i përkt pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se *“Ne lidhje me mjetet: Mjet special per pastrimin e reres dhe bregut te liqenit, Freze pastrimi i trotuareve nga debora, Fshese automatike me motorr me djegie te brendshme e pajisur ne sistem thithje per pastrimin e trotuareve, jo me pak se 2 (dy) cope, Fshese automatike e pajisur me sistem thithes dhe me kosh per grumbullimin e mbeturinave, jo me pak se 6 (Gjashte) cope, Mjet special per pastrimin e liqenit ne thelesi nga algat/leshterikeve apo mbetjet e ndryshme me kapacitet deri 4 ton, jo me pak se 1 (nje) cope AK duhet te jete me e qarte dhe te percaktoje mire llojin e mjetit dhe specifikimet e ketyre mjeteve qe Operatoret Ekonomike pjesmares ti hartojne ofertat e tyre ne perputhje me ato mjete qe ju kerkoni [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik ankimues, në lidhje me mjetet e mësipërm ka ngritur pretendime të përgjithshme dhe nuk ka përcaktuar saktë dhe qartë kërkesat e tij. Akoma me tej, KPP nga shqyrtimi i kriterit të mësipërm, gjykon se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në mënyrë të qartë mjetet që kërkohen, së bashku me përshkrimet e tyre, duke përcaktuar kështu në mënyrë të dukshme edhe qëllimin për të cilin nevojiten këto mjete.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Korsel” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se *“Per mjetet ne pronesi/qera, Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pese) diteve nga mbyllja e dorezimit te ofertave rezervon te drejten e verifikimit te tyre. Ne kete deklarate do te jepen te dhena te sakta te kontaktit te operatorit ekonomik si: Numer cel, adrese emaili, adresa e selise se shoqerise. Nga ana e autoritetit kontraktor do te dergohet nje njoftim si ne adresen elektronike ne SPE edhe ne te dhenat e kontaktit te OE ku do te percaktohet vendi dhe ora e paraqitjes se mjeteve prane ambienteve te Bashkise Pogradec. Ne rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon te gjitha mjetet e deklaruar ne tender, ai do te s’kualifikohet. Gjithashtu ndryshimet qe mund te perkojne me te dhenat e mjetit te deklaruar dhe atyre qe te*

rezultojne nga verifikimi fizik i tyre do te perbej shkak per skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar.

Ky kriter i vendosur cenon fshehtesine e procesit si nje nga hallkat themelore te ketij Legjislacioni sepse KVO ose AK nuk duhet te kete asnje kontakt me Operatoren pjesmares deri ne perfundimin e vleresimit te ofertave. Duke ju referuar nenit 62 "Detyrimet gjate zbatimit te kontrates" te LPP, autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e sukseshem te kontrates. Sjellim ne vemendje se, referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e sherbimit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se, si me siper cituar. Ne rastin konkret, ju si autoritet kontraktor po prokuroni nje sherbim me objekt per te cilen ka zgjedhur llojin e procedures "Procedure e Hapur" dhe jo sherbim konsulence, ne te cilen te gjykohet se cilin nga pjesmarresit ka dhene zgjidhjen me te favorshme apo me optimale lidhur me mjetet e propozuara. Paraqitja e kesaj Deklarate eshte e pavlefshme edhe ne rastin e mjeteve me kontrate porosie. Kerkojme qe ky kriter te hiqet.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, "Kapaciteti teknik", pika 2.3.14/f nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

f)-Për mjetet në pronësi/qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga mbyllja e dorëzimit të ofertave rezervon të drejtën e verifikimit të tyre. Në këtë deklaratë do të jepen të dhëna të sakta të kontaktit të operatorik ekonomik si: Numër cel, adresë emaili, adresa e selisë së shoqërisë. Nga ana e autoritetit kontraktor do të dërgohet një njoftim si në adresën elektronike në SPE edhe në të dhënat e kontaktit të OE ku do të përcaktohet vendi dhe ora e paraqitjes së mjeteve pranë ambienteve të Bashkisë Pogradec. Në rast se Operatori ekonomik nuk i paraqet apo disponon të gjitha mjetet e deklaruara në tender, ai do të s'kualifikohet. Gjithashtu ndryshimet që mund të përkoojnë me të dhënat e mjetit të deklaruar dhe atyre që të rezultojnë nga verifikimi fizik i tyre do të përbëj shkak për skualifikim dhe nisjen e procedurave administrative parashikuar nga neni 13 i ligjit 9643 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

III.7.2. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se: "1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: "b. aftësia teknike: operatorët ekonomike vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike , aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përkthyer nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

III.7.3. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se

zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.7.4. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin nga operatorët ekonomikë të një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga mbyllja e dorëzimit të ofertave rezervon të drejtën e verifikimit të mjeteve të deklaruara nga operatori ekonomik, nuk është një kriter diskriminues dhe është në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës. Është në të drejtën e autoriteteve kontraktore të vendosin ato kriteret ligjore të cilat I paraqesin një panoramë të qartë këtij të fundit mbi kapacitetin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. E rëndësishme është që kriteret të mos jenë diskriminuese dhe të ofrojnë një trajtim të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe të jenë në proporcion me natyrën e kontratës. Pra sa më sipër, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të përcaktojë kriteret që referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, lidhur me vërtetimin e disponimit të mjeteve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke kryer verifikimin në lidhje me disponimin e tyre sipas të gjitha kriterëve të kërkuara dhe në përputhje me dokumentacionin e deklaruar nga operatorët ekonomikë në momentin e dorëzimit të ofertave.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Korsel” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se *“Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te disponoje nje pike per larjen dhe dizinfektimin e kazaneve (lavazh) ne pronesi apo me qera (ne formen e kerkuar nga ligji, me certifikate pronesie nese eshte ne pronesi, me kontrate qeraje nese eshte marre me qera shoqeruar me dokumentacionin e perkates.*

*Ne lidhje me kete kriter duhet te hiqet nga Kriteret e Vecanta sepse Operatoret Pjesmares mund ta realizojne ne ambjentet e Oficines qe ju keni kerkuar prej 1000 m 2 dhe mund te kerkoni vetem paisjet e lavazhit. Kerkojme qe ta modifikoni kete kriter”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.14/h nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

*h) Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te disponoje nje pike per larjen dhe dizinfektimin e kazaneve (lavazh) ne pronesi apo me qera (ne formen e kerkuar nga ligji, me certifikate*

*pronësie nëse është në pronësi, me kontrate qeraje nëse është marrë me qera shoqeruar me dokumentacionin e përkatës.*

III.8.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomike vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike , aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.8.3. Autoriteti kontraktor në kthim përgjigje ka argumentuar: *Ne lidhje me pretendimet se pika e lavazhit mund të gjendet edhe brenda truallit prej 1,000 m2 të kerkuar brenda territorit të Bashkisë Pogradec, KSHA konstaton se referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit në asnjë rast nuk është përjashtuar opsioni se pika e lavazhit mund të jete brenda territorit prej 1.000 m2 të percaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit si pike e nevojshme jo vetëm për vendosjen e mjeteve (autopark) por njëkohësisht edhe për kryerjen e shërbimit të larjes së konteniereve. KSHA gjykon se në asnjë rast referuar dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk është ndaluar që operatori ekonomik të disponojë brenda të njejtit territori pikën e lavazhit. KSHA gjykon se për autoritetin kontraktor është e nevojshme që të vertetohet se operatori ekonomik plotëson kapacitetin teknik në përputhje me kërkesën ku parashikohet se Operatori ekonomik që paraqet ofertën duhet të disponojë një pike për larjen dhe dizinfektimin e kazanëve (lavazh) në pronësi apo me qera (në formën e kerkuar nga ligji, me certifikate pronësie nëse është në pronësi, me kontrate qeraje nëse është marrë me qera shoqeruar me dokumentacionin e përkatës pavarësisht faktit nëse kjo pike ndodhet brenda ose jashtë territorit prej 1,000 m2 të kerkuar. KSHA gjykon se kërkesa e mesipërme është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit dhe është lënë në cmim të operatoreve ekonomike zgjedhja e vendodhjes së pikës.”*

III.8.4. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.8.5. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me modifikimin e kriterit për sa i përket pikës për larjen dhe dezinfektimin e kazanëve, KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, ashtu siç edhe autoriteti kontraktor argumenton në kthimin e përgjigjes së ankesës së

ankimuesit, konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë kriterin duke lënë të hapur mundësinë e disponimit të një pike lavazhi për larjen e kazanëve, në pronësi ose me qira dhe nuk ka përcaktuar asnjë vendndodhje konkrete të kësaj të fundit. Pra, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për heqjen e këtij kriteri, me argumentin se lavazhin mund ta disponojë në ambientet në pronësi të tij të kërkuara në pikën 2.3.14/g të dokumentave të tenderit, nuk qëndron, pasi autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar asnjë kërkesë të tillë në lidhje me vendndodhjen e lavazhit, por ka lënë të hapur kërkesën për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një pikë lavazhi për larjen dhe dezinfektimin e kazanëve, në një nga format ligjore të disponimit të pronësisë (në pronësi ose me qira).

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: ” *Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te paraqese dokumentin (aktmarreveshje apo kontrate mirembajtje) qe do te kryej sherbimin e mirembajtjes kazanave me subjektin qe do te riparoje kazanat e mbledhjes se mbeturinave. Se bashku me aktmarreveshjen apo kontraten e mirembajtjes duhet te paraqitet dhe dokumentacion provues qe ofruesi i sherbimit ka si aktivitet te tij mirembajtjen e kazaneve. Edhe per sa i perket keti kriteri Operatoret Ekonomike mund ta realizojne vete kete proces pune pa pasur nevojten e Subjekteve te profilizuara sepse ne dijenine tone nuk ka Subjekte qe merren me riparimin e konteniereve, por Operoret e realizojne vete prane Ofcinave te tyre. Prandaj kerkojme heqjen e ketij kriteri te panevojshem.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.9.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.14/i, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri:

“*i) Operatori ekonomik qe paraqet oferten duhet te paraqese dokumentin(aktmarreveshje apo kontrate mirembajtje) qe do te kryej sherbimin e mirembajtjes kazanave me subjektin qe do te riparoje kazanat e mbledhjes se mbeturinave. Se bashku me aktmarreveshjen apo kontraten e mirembajtjes duhet te paraqitet dhe dokumentacion provues qe ofruesi i sherbimit ka si aktivitet te tij mirembajtjen e kazaneve*”.

III.9.2. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

a) *kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*

b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*”.

III.9.3. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.9.4. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për kualifikim nuk duhet të japë kërkesa në tejkallim të objektit, natyrës dhe llojit të procedurës që prokurohet, por duhet të përcaktojë kriterë jo diskriminues, të cilat nuk pengojnë konkurrencën e lirë, dhe janë gjithpërfshirëse duke lejuar pjesëmarrjen edhe të biznesit të vogël, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, përcaktimi i kriterit të mësipërm në lidhje me mirëmbajtjen e kazanëve është një kriter në përputhje me proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës, pasi për autoritetin kontraktor është i rëndësishëm ky shërbim, në kushtet kur kërkohet shërbim i pandërprerë i pastrimit, për të cilin nuk mund të tolerohen mangësitë e kazanëve. Gjithashtu referuar preventivit dhe volumeve të punës është përcaktuar zëri për mirëmbajtjen e kontenierëve. Por, autoriteti kontraktor, në kriterin e mësipërm duhet të përcaktojë qartë të gjitha format dhe mënyrat ligjore të provueshmërisë së ofrimit të këtij shërbimi nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe të mos e kufizojë këtë kërkesë vetëm në kontratën e mirëmbajtjes së operatorit ekonomik ankimues me subjekte të tjerë. Akoma më tej, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë dokumentat konkretë që nevojiten për të provuar disponimin e këtij shërbimi nga ana e operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Korsel” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë”, me nr. REF-46811-12-26-2019, me objekt “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit Pogradec dhe Njësie Administrative”, me fond limit 625.000.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.



2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Korsel” sh.p.k.
  5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 24 Protokoli,**  
**Datë 09.01.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

|                      |                     |                      |                     |
|----------------------|---------------------|----------------------|---------------------|
| <b>Nënkryetar</b>    | <b>Anëtar</b>       | <b>Anëtar</b>        | <b>Anëtar</b>       |
| <b>Enkeleda Bega</b> | <b>Vilma Zhupaj</b> | <b>Lindita Skeja</b> | <b>Merita Zeqaj</b> |

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**